VËLLIMI I, NR. 1

Korrik 2015

Observeri i Sektorit të Sigurisë së Kosovës

Ky botim është pjesë e projektit "Monitorimi i Sektorit të Sigurisë së Kosovës" të përkrahur nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP), i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e KIPRED-it, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo i KCSF-së.

Përgatitur nga: Lulzim Peci, Mentor Agani, Gent Gjikolli, Blerim Murtezi dhe Blend Zyrapi

Copyright © 2015, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të reprodukohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 227 778.

Botuar nga:

KIPRED
INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE
KOSOVAR INSTITUTE FOR POLICY RESEARCH AND DEVELOPMENT

Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Abdyl Frashëri, No. 44
10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778
www.kipred.org

Përmbajtja

Hyrje 4
1. Monitorimi i Sektorit të Punëve të Brendshme 6
2. Monitorimi i Sektorit të Forcës së Sigurisë 16
3. Monitorimi i Sektorit të Inteligjencës 23
4. Udhëkryqi i tansformimit të Forcës së Sigurisë në Forcat e Armatosura të Kosovës..... 33
5. Pasqyrë analitike e hulumtimit të opinionit publik..... 46

HYRJE

Observeri i Sektorit të Sigurisë së Kosovës (OSSK) është pjesë e projektit dyvjeçar të KIPRED-it, "Monitorimi i Sektorit të Sigurisë së Kosovës", vëllimet e të cilit do të trajtojnë zhvillimet në sektorin e sigurisë së Kosovës në periudha katër mujore.

Vëllimi i parë i Observerit të Sektorit të Sigurisë së Kosovës trajton në mënyrë analitike çështjet kyçe të sektorit të punëve të brendshme, të inteligjencës dhe të Forcave të Sigurisë, që e kanë mbizotëruar debatin publik dhe mbikëqyrjen parlamentare të këtyre sektorëve gjatë periudhës prill-korrik 2015. Në një punim të veçantë të analizës së politikave publike, OSSK-ja trajton, po ashtu, edhe transformimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK), si dhe i prezanton rezultatet e hulumtimit të opinionit publik lidhur me besimin, sa i përket çështjeve të sigurisë, në institucionet përkatëse qeveritare dhe në krerët e tyre, si dhe në komisionet përkatëse parlamentare.

Në seksionin e punëve të brendshme janë analizuar shkurtimisht zhvillimet dhe mangësitë institucionale lidhur me kërcënimet dhe rrezikun nga terrorizmi, si dhe janë prezantuar gjetjet e hulumtimit të opinionit publik lidhur me besimin e qytetarëve, sa i përket çështjeve të sigurisë, në Ministrin e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës.

Në seksionin e Forcës së Sigurisë janë analizuar zhvillimet lidhur me transformimin e FSK-së në FAK, çështjet e procedurave rreth operacioneve të FSK-së në veri të vendit, si dhe subordinimi i kreut të tyre ndaj autoriteteve civile, dhe, në fund, janë prezantuar gjetjet e hulumtimit të opinionit publik lidhur me besimin e qytetarëve, sa i përket çështjeve të sigurisë, në Ministrin e FSK-së dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në seksionin e inteligjencës janë analizuar shkurtimisht zhvillimet dhe mangësitë institucionale lidhur me konfliktin në Kumanovë, si dhe janë prezantuar gjetjet e hulumtimit të opinionit publik lidhur me besimin e qytetarëve, sa i përket çështjeve të sigurisë, në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë dhe në Drejtorin e saj.

Çështjet e menaxhimit të sigurisë kombëtare, përkatësisht, të funksionimit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, janë trajtuar në seksionin e punëve të brendshme dhe në atë të inteligjencës, dhe për këtë arsye në këtë edicion nuk u është kushtuar ndonjë seksion i veçantë.

Në fund të këtij vëllimi të OSSK-së prezantohet edhe një analizë e shkurtër e gjetjeve kyçe të hulumtimit të opinionit publik për Sektorin e Sigurisë së Kosovës.

1. MONITORIMI I SEKTORIT TË PUNËVE TË BRENDSHME

Hyrje

Në periudhën prill-korrik 2015, Sektorin e Punëve të Brendshme e kanë mbizotëruar dy çështje, ajo e kërcënimeve terroriste nga ISIS-i (Shteti Islamik i Irakut dhe Shamit), dhe përleshja e armatosur në Kumanovë. Kjo e fundit nuk trajtohet këtu, meqë është analizuar në hollësi në seksionin e Monitorimit të Sektorit të Inteligjencës.

Menaxhimi i këtyre kërcënimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Policia e Kosovës (PK), vuri në dukje mangësitë e koordinimit dhe të posedimit të informatave mes këtyre dyjave, si dhe komunikimin kontraverz me publikun lidhur me nivelin e rrezikut të këtyre kërcënimeve. Këto deformime institucionale janë pasoja, po ashtu, edhe të mungesës së kornizës juridike dhe të mekanizmave që këto të meta do t'i rregullonin përmes procedurave dhe mekanizmave përkatës.

Ky seksion trajton, po ashtu, edhe mbikëqyrjen e Sektorit të Punëve të Brendshme nga ana e Komisionit Parlamentar për Siguri, dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe besimin e opnionit publik në institucionet përkatëse ekzekutive dhe legjislative.

Kërcënimi terrorist i ISIS-it

Dalja në media e një videoje të ISIS-it[1], ku pjesëtari i tij, Ridvan Haqifi nga fshati Bukovik i Gjilanit, i njohur edhe si Abu Muqatil Al-Kosova,[2] kërcënoi që ISIS-i do të sulmonte qytetarët e Kosovës që konsiderohen jobesimtarë[3], si dhe i një telefonate të zhvilluar mes një personi nga Gjilani dhe një personi tjetër me origjinë shqiptare nga Maqedonia që tash ndodhet në Siri, bëri që Policia e Kosovës t'i shtojë masat e sigurisë në të tërë territorin e vendit.[4] Pasoja e parë e këtij kërcënimi të ISIS-it ishte anulimi i koncertit tradicional për festën e pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të

---

[1] Youtube: ISIS kërcënon shqiptarët dhe Ballkanin, mesazh në shqip për akte terrori lajm, 5 qershor 2015, https://www.youtube.com/watch?v=1AmJ71iBSD0/, (qasur më 5 qershor 2015).

[2] Gazetaexpress: Profil: Kush është kosovari i ISIS'it që po kërcënon shqiptarët dhe Ballkanin, 5 qershor 2015, http://www.gazetaexpress.com/lajme/profil-kush-eshte-kosovari-isisit-qe-po-kercenon-shqiptaret-dhe-ballkanin-105798/?archive=1, (qasur më 5 qershor 2015).

[3] Telegrafi: Ekskluzive: ISIS kërcënon jobesimtarët në Kosovë dhe Shqipëri (Video), 4 qershor 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/ekskluzive-isis-kercenon-jobesimtaret-ne-kosove-dhe-shqiperi-video-2-64670.html

[4] Top-channel: Kërcënimet e ISIS, rriten masat e sigurisë në Kosovë. Personat e përgjuar mbahen nën mbikëqyrje, 2 korrik 2015, http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=303255&ref=ml/, (qasur më 4 Korrik 2015).

Amerikës[5]. Po ashtu, në vendbanime të shumta të Kosovës, pjesëtarët e PK-së filluan të patrullonin të veshur me këmisha anti-plumb, ndërkohë që institucionet vendore dhe ndërkombëtare u alarmuan për rrezikun e lartë nga sulmet terroriste.[6]

Mirëpo, Policia e Kosovës e pranoi publikisht që për një kohë kishte patur mobilizim të shtuar dhe ngritje të masave të sigurisë vetëm me 23 korrik 2015. Në një debat televiziv, Drejtori i Departmentit për Anti-Terrorizëm të PK-së, z. Fatos Makolli, deklaroi që Kosova nuk kishte patur ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë, mirëpo, duke i patur parasysh sulmet terroriste në vende si Franca, Tunizia, dhe Turqia, Policia e Kosovës vlerësoi që ishte i nevojshëm shtimi i masave të sigurisë.[7]

Edhe përkundrejt këtij rreziku serioz, që ishte i njohur për institucionet e Kosovës dhe misionet e huaja, asnjëri nga krerët institucional, përfshirë këtu edhe Presidenten, Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Brendshme, nuk iu drejtua qytetarëve lidhur me kërcënimin me të cilin po përballej vendi, duke i lënë kësisoj në një amulli informative për një çështje që kishte të bënte drejtëpërdrejt me sigurinë e tyre.

Terrorizmi: Nga kërcënimi në një rrezik të drejtpërdrejtë

Periudha gjatë të cilës ISIS-i paraqiste vetëm kërcënim për Kosovën përfundoi më 11 korrik 2015, me arrestimin, nga ana e Policisë së Kosovës, të tre personave që dyshohej se po përgatisnin aksion terrorist afër liqenit të Badovcit.[8] Më pas, PK-ja konfirmoi që te të arrestuarit ishin gjetur prova materiale që ata i lidhnin me ISIS-in.[9] Policia, pas kësaj, i arrestoi edhe dy persona të tjerë që ishin të

---

5 Telegrafi.com: Sulmet e ISIS në Kosovë kërcënim real: Anulohet koncerti kushtuar SHBA-ve (Foto), 29 qershor 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/sulmet-e-isis-ne-kosove-kercenim-real-anulohet-koncerti-kushtuar-shba-ve-foto-2-66112.html/, (qasur më 29 qershor 2015).
6 Burime të KIPRED-it brenda Qeverisë së Kosovës dhe EULEX-it, qershor 2015.
7 KTV: Rubikon-Frika nga terrorizmi/ndikimi i shtetevete huaja, 23 korrik 2015, http://www.kohavision.tv/video/rubikon/9860/ (qasur më 24 korrik 2015).
8 Telegrafi: Arrestohen afër Badovcit 3 pjesëtarë të ISIS-it, 11 korrik 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/arrestohen-af-r-badovcit-3-pjes-tar-t-isis-it-2-66750.html/, (qasur më 11 korrik 2015).
9 Policia e Kosovës: Arrestohen pesë persona të dyshuar për përfshirje në vepra penale që ndërlidhen me terrorizëm, 11 korrik 2015, http://www.kosovopolice.com/?page=1,26,4859&offseti=0.

lidhur me tre personat e arrestuar paraprakisht.[10] Dy nga këta ishin arrestuar edhe vitin e kaluar nën akuzën e terrorizmit, mirëpo ishin liruar në mungesë provash.[11]

Rreziku i tentim-aksionit terrorist në Badovc dëshmohet edhe me kërkesën që Policia ia bëri Ujësjellësit Rajonal të Prishtinës për testimin e ujit, për të konstatuar nëse ky përmbante ndonjë substancë helmuese.[12] Këtë kërkesë mediat e ndërlidhën me mundësinë që të arrestuarit mund ta kishin helmuar ujin.[13] PK-ja ishte e shpejtë në reagim ndaj kësaj, duke mohuar atë që tek të arrestuarit janë gjetur substanca helmuese[14]. Mirëpo, rastin e bëri edhe më të ngatërruar avokatja e njërit nga të arrestuarit, që për media fillimisht pohoi se tek klienti i saj ishte gjetur helm; mirëpo, në një deklaratë tjetër, që e dha dy orë më vonë, ajo e mohoi një gjë të tillë.[15]

Po ashtu, disa ditë pas arrestimit të të dyshuarve, në të njëjtin vend ishin gjetur edhe dy çanta me armë dhe maska, dhe sipas Drejtorit të Departamentit për Anti-Terrorizëm të PK-së, të gjithë treguesit çojnë kah ajo që këto çanta dhe pajisje u takonin personave të arrestuar afër liqenit të Badovcit.[16]

Gjatë të njëjtës kohë kur i bëri arrestimet dhe hapjen e proceseve gjyqësore ndaj të dyshuarve, Policia e Kosovës i shtoi masat e sigurisë përreth liqeneve të Kosovës, duke vendosur patrulla me armë të gjata[17]. Përsëri, as në këtë rast nuk pati kurrfarë njoftimi të publikut për nivelin e rrezikut nga sulmet eventuale nga ISIS-i.

---

[10] Policia e Kosovës: Arrestohen pesë persona të dyshuar për përfshirje në vepra penale që ndërlidhen me terrorizëm, 11 korrik 2015, http://www.kosovopolice.com/?page=1,26,4859&offseti=0/, (qasur me 11 korrik 2015).
[11] Zëri: Dy nga të arrestuarit, ish-luftëtarë të ISIS-it, 14 korrik 2015, http://www.zeri.info/aktuale/42062/dy-nga-te-arrestuarit-ish-luftetare-te-isis-it/, (qasur më 14 korrik 2015).
[12] Telegrafi: Zyrtare: Nuk ka helmim të ujit të Badovcit, 11 korrik 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/zyrtare-nuk-ka-helmim-te-ujit-te-badocit-2-66779.html, (qasur më 11 korrik 2015).
[13] Telegrafi: Zyrtare: Dyshohet për helmim të ujit të Badovcit, 11 korrik 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/zyrtare-dyshohet-per-helmim-te-ujit-te-badovcit-2-66762.html, (qasur më 11 korrik 2015).
[14] KTV: Lajmet e Mbrëmjes, 11.07.2015, http://www.kohavision.tv/video/lajmet/9799/
[15] Avokatja pendohet për deklaratën se të dyshuarit për terrorizëm iu gjet helm [video], 12 korrik 2015, http://koha.net/?id=3&l=66117, (qasur me 12 korrik 2015).
[16] KTV: Rubikon: Frika nga terrorizmi/ndikimi i shteteve te huaja, 23 korrik 2015, http://www.kohavision.tv/video/rubikon/9860/, (qasur më 23 korrik 2015).
[17] Telegrafi: Policë me kallashnikovë skaj liqeneve, 13 korrik 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/polic-me-kallashnikov-skaj-liqeneve-2-66830.html, (qasur më 13 korrik 2015).

Kundërthëniet midis deklarimeve publike të MPB-së dhe të PK-së

Deklarimet publike të Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, dhe të drejtuesve të Policisë së Kosovës vënë në pah kundërthëniet midis tyre rreth vlerësimit të kërcënimeve nga terrorizmi dhe posedimit të informatave lidhur me të.

Përerisa kërcënimet (përmes videos) dhe rreziku nga terrorizmi (rasti i Badovcit), sipas Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, nuk paraqisnin rrezik për sulme terroriste[18], për Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së, z. Shpend Maxhuni, terrorizmi paraqiste kërcënim evident për Kosovën[19]. Po ashtu, edhe Drejtori i Departamentit për Anti-Terrorizëm, z. Fatos Makolli, vlerëson që vetë pjesëmarrja e qytetarëve të Kosovës në luftërat e huaja, dhe atë përkrah ISIS-it dhe organizatave të tjera terroriste, paraqet një kërcënim potencial për sulme terroriste.[20]

Po ashtu, përderisa, më 23 korrik 2015, Drejtori i Departamentit për Anti-Terrorizëm të PK-së, deklaroi që policia ka qenë e informuar për aktivitetet e personave të arrestuar tek liqeni Badovcit, dhe se ka patur informacione për veprimet e tyre,[21] Ministri Hyseni një ditë më vonë e minimizoi rrezikun nga terrorizmi, duke deklaruar që institucionet e Kosovës nuk posedojnë ndonjë informacion kredibël për ndonjë rrezik të sulmeve terroriste.[22]

Këto vlerësime të ndryshme të nivelit të kërcënimeve dhe të rreziqeve nga terrorizmi, mund të jenë edhe pasojë e mos menaxhimit adekuat të sektorit të sigurisë në vend dhe e mangësive të kornizës ligjore në fushën e sigurisë. Në këtë aspekt, fillimisht duhet të theksohet se edhe përkundrejt përballjes me kërcënime dhe rreziqe evidente nga terrorizmi, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, që sipas ligjit është i obliguar të mbajë mbledhje të paktën një herë në tre muaj[23], nuk ka mbajtur asnjë takim që nga muaji mars 2015.

---

[18] KTV: Lajmet e mbrëmjes, 21 korrik 2015,
http://www.kohavision.tv/video/lajmet/9849/, (qasur më 21 korrik 2015).
[19] KTV: Lajmet e mbrëmjes 22 korrik 2015,
http://www.kohavision.tv/video/lajmet/9853/, (qasur më 22 korrik 2015).
[20] KTV: Rubikon: Frika nga terrorizmi/ndikimi i shteteve te huaja, 23 korrik 2015,
http://www.kohavision.tv/video/rubikon/9860/, (qasur më 23 korrik 2015).
[21] *Ibid.*
[22] Gazetaexpress: Komiteti Skender Hyseni, 25 korrik 2015,
http://www.gazetaexpress.com/komiteti/skender-hyseni-2070/, (qasur më 25 korrik 2015).
[23] Neni 5, Ligji për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, 13 mars 2008,
http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2521

Për më tepër, Kosova nuk ka asnjë akt juridik me të cilin përcaktohet niveli i kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë, as autoritet që e përcakton atë, dhe as komunikim me publikun. Po ashtu, nuk ka asnjë akt juridik që i definon procedurat e shpalljes së organizatave si terroriste, dhe as nuk e ka të përcaktuar infrastrukturën kritike që duhet të mbrohet në raste të kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë. Në anën tjetër, duhet pasur parasysh, se nuk është e thënë që informimi i qytetarëve për nivelin e rrezikut nga sulmet terroriste detyrimisht do të shkaktojë panic. Informimi, përkundrazi, mund të ketë ndikim pozitiv në bashkëpunimin e tyre për parandalimin dhe zbulimin me kohë të veprimeve të tilla.

Dokumenti kyç që i përcakton udhëzimet dhe procedurat për menaxhimin e situatave emergjente, përfshirë këtu edhe situatat e krijuara nga veprimet terroriste, është Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave dhe Plani i Reagimit Kombëtar, që Qeveria e ka aprovuar në vitin 2010. Në zbatimin e tij, rolin kyç e ka Ministri dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Megjithatë, zbatimi i tij ka ngecur edhe 5 vite pas aprovimit. Ligji për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, si një ndër institucionet kyçe të menaxhimit të situatave emergjente, është aprovuar më 27 shkurt 2014[24]; më pas, Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Agjencisë është aprovuar në fund të vitit 2014[25]; ndërkaq, Rregullorja për Themelimin, Përbërjen dhe Procedurën e Komisionit për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe të Zëvendës-drejtorëve të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent është aprovuar në fillim të vitit 2015[26]. Rrjedhimisht, kjo agjenci shumë e rëndësishme për menaxhimin e situatave që përkojnë me sigurinë e vendit mbetet ende jo-funksionale.

---

[24] Ligji per Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/LIGJI_NR._04-L-230_PER_AGJENCINE_E_MENAXHIMIT_EMERGJENT.pdf

[25] Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/RREGULLORE_(MPB)_NR._04_2014_PER_ORGANIZIMIN_E_BRENDSHEM_DHE_SISTEMATIZ....pdf

[26] Rregullorja për Themelimin, Përbërjen dhe Procedurën e Komisionit për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe zv. Drejtorëve të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/RREGULLORE_(MPB)_NR._01_-2015__PER_THEMELIMIN,_PERBERJEN_DHE_PROCEDUREN_E_KOMISIONIT_PER_EMERIMIN_E_DREJTORIT_TE_PERGJITHSHEM_DHE_ZEVENDESDREJTOREVE_NE_AGJENCINE_E_MENAXHIMIT_EMERGJENT.pdf

Po ashtu, në qershor të vitit 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmi [27], që, mes tjerash, parasheh edhe krijimin e funksionit të Koordinatorit Nacional Kundër Terrorizmit, që do të jetë përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në luftën kundër terrorizmit. Kjo parashihet të ndihmohet nga Sekretariati i Koordinatorit Nacional Kundër Terrorizmit, përgjegjësi e të cilit do të jetë mbledhja e informatave dhe e të dhënave nga institucionet e tjera, me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të tyre, si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional. Krijimi i këtyre dy trupave shumë të rëndësishëm për luftën kundër terrorizmit nuk është inicuar ende nga Qeveria e Kosovës, dhe ky fakt është një indikator shumë i rëndësishëm, si i dobësive institucionale të Kosovës në këtë fushë, ashtu edhe i ngecjeve serioze në zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Terrorizmit.

Mbikëqyrja Parlamentare

Në tri mbledhjet që Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës i ka mbajtur gjatë periudhës prill-korrik, kanë raportuar krerët më të lartë të institucioneve të Sektorit të Punëve të Brendshme.

Në mbledhjen e 17 prillit 2015, për punën e Inspektoratit Policor raportoi Kryeshefi Ekzekutiv i tij, z. Fitim Shishani[28]. Pas këtij raportimi, Kryeshefit Shishani ju kërkuan informata shtesë nga deputeti Anton Quni, gjegjësisht shënime të detajuara lidhur me punësimet në Inspektorat gjatë periudhës katërvjeçare, përfshirë transferet, përgaditjet e kuadrove, ngritjet e tyre në karrierë, procedurat e ndërmarra disiplinore, dhe, po ashtu, edhe procedurat motivuese. Mirëpo, me kërkesë të kryesuesit të kësaj mbledhjeje, deputetit Fadil Demaku, kërkesa e deputetit Quni mbeti për t'u diskutuar dhe vendosur në mbledhjen e radhës të këtij Komisionit. Mirëpo, deri në fundiin e korrikut 2015, ky propozim i deputetit Quni nuk u trajtua në asnjërën nga mbledhjet pasuese të Komisionit.

Në mbledhjen e 18 majit 2015, Ministri i Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni, raportuan lidhur me ngjarjet e

[27] Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Terrorizmit, 2012-2017 http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategy_for_Counter_Terrorism_2012-2017_alb.pdf, qershor, 2012
[28] Shih procesverbalin e Komisionit të datës 17 prill 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2015_04_17_11_5891_al.pdf

Kumanovës[29]. Në këtë mbledhje Ministri Hyseni mohoi që ai dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Maxhuni, të kenë pranuar raportin e Agjencisë për Inteligjencë të Kosovës që ishte botuar në media, ndërkaq, deputetja Aida Dërguti, që njëkohësisht është edhe anëtare e Komisionit për Mbikëqyrje të Agjencionit Kosovar për Inteligjencë, theksoi që përfaqësuesit e AKI-së në mbledhjen e Komisionit të datës 12 maj 2015 kanë konfirmuar se këtë raport ia kanë dorëzuar Presidentes dhe Kryeministrit. Me këtë rast, u shtrua çështja e ndarjes së këtij raporti me Ministrin e Brendshëm. Kryetari, z. Daut Haradinaj, propozoi një takim të përbashkët të dy Komisioneve për këtë çështje. Mirëpo propozimi për mbajtjen e kësaj mbedhjeje të përbashkët, nuk u shtrua në asnjërin nga takimet pasuese të këtyre Komisioneve.

Në mbledhjen e 22 korrikut 2015, raportoi Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni[30]. Në këtë mbledhje, Drejtori Maxhuni theksoi që Kosova është e rrezikuar nga terrorizmi, që ajo mund të jetë cak i sulmeve terroriste, mirëpo kjo nuk është burim i terrorizmit. Ai theksoi, po ashtu, që nuk ka vend për panik, dhe me këtë rast edhe shprehu mirënjohje për raportimin e qytetarëve në zbulimin e rastit të Badovcit[31]. Sikurse edhe në mbledhjet e analizuara më sipër, edhe në këtë raportim u vu në pah konfuzioni ndër-institucional në vlerësimin e rrezikut nga terrorizmi.

Besimi i qytetarëve në Ministrin e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës.

Të anketuarit e kanë patur mundësinë e vlerësimit të besimit që e kanë për institucionet dhe krerët institucionalë nga numri 1 deri në numrin 5, ku numri 1 e paraqet nivelin më të ulët të besimit, ndërkaq ai 5 më të lartin.





[29] Shih procesverbalin e Komisionit të datës 18 maj 2015, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2015_05_18_10_5948_al.pdf

[30] Procesverbali i kësaj mbledhjeje ende nuk është publikuar në web-faqën e Kuvendit të Kosovës.

[31] KTV: Lajmet e Mbrëmjes, 22 korrik 2015, http://www.kohavision.tv/video/lajmet/9853/

Nga këto dy institucione, marrë në përgjithësi, qytetarët e Kosovës i besojnë më së shumti Policisë së Kosovës. Ndërkaq, Ministri i Punëve të Brendshme e gëzon një besim mesatar të qytetarëve. Ky është besimi i përgjithshëm që është fituar nga anketuesit në të tërë territorin e Republikës së Kosovës.



Në bazë të etnisë, është interesant fakti që Policia e Kosovës te komunitetet e tjera, joshqiptare dhe joserbe, gëzon besim më të lartë se besimi që e ka ndër shqiptarët. E njëjta vlen edhe për besimin në Ministrin e Punëve të Brendshme, që te komunitetet joshqiptare dhe joserbe është më i lartë se ai që e ka nga komuniteti shqiptar. Ndërkaq, komuniteti serb i beson pak më tepër Policisë, dhe fare pak Ministrit të Punëve të Brendshme.



Te shqiptarët që jetojnë në veri të Kosovës, përkatësisht në veri të Mitrovicës, përqindjen





më të madhe të besimit e gëzon Policia e Kosovës. Ndërkaq, besimi që këta e kanë në Ministrin e Punëve të Brendshme është nën mesatare.

Ndërkaq, sa i përket komunitetit serb në veri dhe në jug të Kosovës, Policia e Kosovës gëzon besim pak më të lartë, si në veri, ashtu edhe në jug, ku serbët e jugut kësaj i besojnë më shumë se ata të

veriut. Sa i përket Ministrit të Punëve të Brendshme, serbët e veriut nuk i besojnë fare, ndërkaq, serbët e jugut i besojnë në një përqindje fare të vogël.

Sa i



përket shpërndarjes sipas rajoneve të Republikës së Kosovës, përsëri, besimin më të lartë të qytetarëve e gëzon Policia e Kosovës. Policia besimin më të lartë e gëzon në Ferizaj dhe në Mitrovicë. Ndërkaq, besim më të ulët kjo ka në rajonin e Veriut të Kosovës, pasuar nga Gjakova, që ka besim mesatar në Polici. Po ashtu, edhe Ministri i Punëve të Brendshme besimin më të lartë e gëzon në rajonin e Ferizajit, dhe, po ashtu, në atë të Pejës. Ndërkaq, në rajonin e Veriut të Kosovës, Ministri i Punëve të Brendshme e ka besimin më të ulët, pasuar nga rajoni i Gjilanit që atij i beson me një përqindje fare të vogël.

Ndërkaq, nëse besimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës e shikojmë sipas etnisë dhe rajonit, Policia e Kosovës besimin më të madh e gëzon te komunitetet e tjera, joshqiptare dhe joserbe. Te këto komunitetet, Policia besimin maksimal e gëzon në rajonin e Mitrovicës dhe të Ferizajit, dhe përqindjen më të ulët të besimit e ka në rajonin e Gjakovës. Te shqiptarët, Policia besimin më të lartë e gëzon në rajonin e Ferizajit dhe të Pejës, ndërkaq, më të ulëtin në rajonin e Prishtinës. Sa i përket komunitetit serb, Policia e gëzon besimin më të lartë në rajonin e Prishtinës, dhe më të ulëtin në rajonin e Pejës.



Po ashtu, Ministri i Punëve të Brendshme ka besimin më të madh te komunitetet e tjera, joshqiptare dhe joserbe. Në këto komunitete, Ministrit i besojnë më së shumti në rajonin e Mitrovicës dhe të Ferizajit, dhe më së paku në rajonin e Gjakovës. Ndërkaq, ndër shqiptarë, Ministrit më së shumti i beson rajoni i Ferizajit, pasuar nga ai i Pejës, dhe më së paku rajoni Gjakovës. Sa i përket komunitetit serb, besimi në Ministrin e Punëve të Brendshme është shumë i vogël në të gjitha rajonet.

2. MONITORIMI I SEKTORIT TË FORCËS SË SIGURISË

Hyrje

Sektorin e Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë periudhës prill-korrik 2015 e kanë mbizotëruar dy çështje të rëndësishme, procesi i transformimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK), dhe intervenimi dhe operimi i Njësisë së Zhytësve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në lumin Ibër në Mitrovicë, me qëllim të kryerjes së aktivitetit të kërkim-shpëtimit të një personi të zhdukur.

Përpjekjet për transformimin e FSK-së në FAK e vëjnë në dukje paaftësinë e partnerëve qeveritarë, PDK-së dhe LDK-së, për menaxhimin e këtij procesi, që është duke u refuzuar nga Lista Serbe. Duke patur parasysh kundërshtimin e Serbisë, si dhe varshmërinë e plotë të Listës Serbe nga qëndrimet e Beogradit, gjasat për krijimin e FAK-ut janë minimale.

Trajtimi i interventimit të Njësive Zhytëse të FSK-së në lumin Ibër, në Mitrovicë, i nxjerr në shesh problemet që mund të shfaqen në të ardhmen lidhur me veprimin e FSK-së në veri të Kosovës, si dhe lidhur me subordinimin e FSK-së ndaj autoriteteve civile të vendit.

Procesi i transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës

Një çështje tejet e rëndësishme që e ka karakterizuar këtë sektor gjatë periudhës prill-korrik 2015, ka qenë pa dyshim ajo e përpjekjeve për transformimin e FSK-së në FAK. Pos asaj që nuk arriti të përmbyllej gjatë mandatit të kaluar qeverisës (2010-2014), ky proces vazhdoi të çalonte edhe gjatë këtij mandati, dhe kryesisht për shkak të mospajtimit të Listës Serbe, meqë për formimin e Forcës së Armatosur të Kosovës nevojiten ndryshime kushtetuese që nuk mund të bëhen pa dy të tretat e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, së bashku me dy të tretat e votave të deputetëve që përfaqësojnë komunitetet e pakicave në Kuvend.

Gjatë votimit të kabinetit qeveritar për miratimin e draft-ligjit për shndërrimin e FSK-së në FAK, në mbledhjen e tij të 27 majit 2015, dy anëtarë të këtij kabineti nga Lista Serbe votuan kundër tij. Njëri nga ta, mosvotimin e draft-ligjit e ndërlidhi me mungesën e ndonjë debati për atë si komuniteti serb

do të përfaqësohet në FAK. Po ashtu, sipas tij, në mungesë të këtij debati, Lista Serbe do ta kishte të njëjtin qëndrim edhe sikur ligji të kalonte në Kuvend për miratim[32].

Pas kësaj u paraqitën spekulime mediale lidhur me atë që Lista Serbe do të ngulmonte për formimin e një batalioni serb në kuadrin e FAK-ut, si kusht për votimin e tij. Një mundësi e tillë u kundërshtua nga Ministri i MFSK-së, z. Haki Demolli, që theksoi se atij askush nuk i kishte kërkuar diçka të tillë, dhe se ai nuk do të pajtohej me një kësi propozimi, pavarësisht nga ajo se kush do të ishte propozuesi[33]. Po ashtu, edhe ish-komandanti i FSK-së, Gjeneral Kadri Kastrati, tërhoqi vërejtjen që krijimi i një ushtrie të veçantë për serbët e veriut do ta shënonte përfundimisht ndarjen e Kosovës. Kjo madje do të ishte një tregues i fillimit të një lufte të brendshme, mes FAK-ut dhe kësaj ushtrie paralele[34].

Çuditërisht, Draft-ligji për transformimin e FSK-së në FAK iu dërgua Qeverisë nga Ministria e FSK-ja, pa kalimin e ndryshimeve përkatëse kushtetuese në Kuvendin e Kosovës që do ta mundësonin krijimin e FAK-ut. Propozim-amandamentet e Kushtetutës për krijimin e FAK-ut u trajtuan nga Komisioni për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës më 10 korrik 2015. Me shtatë vota për dhe dy kundër, anëtarët e komisionin i kaluan këto amandamente, dhe tash ka mbetur që Kryesia e Kuvendit të vendosë për procedimin e mëtutjeshëm në seancën plenare për votim[35].

Kalimi i Draft-ligjit për FAK-un në Qeverinë e Kosovës, pa u aprovuar ndryshimet e domosdoshme kushtetuese për themelimin e tij, vë një pikëpyetje të madhe për ligjshmërinë e procedimit të këtij draft-ligji në Qeveri, pasi që për këtë nuk ka patur bazë kushtetuese.

Nga ana tjetër, komunitetet pakicë, joshqiptare dhe joserbe, në Kuvendin e Kosovës, përkatësisht Grupi parlamentar 6+, kanë shprehur gatishmëri për ta ndihmuar procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura. Lidhur me këtë, dy përfaqësues të komunitetit turk nga ky grup

---

[32] Telegrafi. Lista Serbe voton kundër transformimit të FSK-së në FAK, http://www.telegrafi.com/lajme/lista-serbe-voton-kunder-transformimit-te-fsk-se-ne-fak-2-64152.html, 27.05.2015.
[33] Zëri. Demolli: Kurrë s'pranoj batalion serb brenda FAK-ut, http://zeri.info/aktuale/33857/demolli-kurre-s-pranoje-batalion-serb-brenda-fak-ut/, 21 maj 2015.
[34] Telegrafi. Gjeneral Kastrati: Formimi i batalionit serb brenda FAK-ut, i rrezikshëm, http://www.telegrafi.com/lajme/gjeneral-kastrati-formimi-i-batalionit-serb-brenda-fak-ut-i-rrezikshem-video-2-63654.html, 18.05.2015.
[35] Koha.net. Republika në FAK përçan deputetët e Komisionit të ligjeve, http://koha.net/?id=27&l=65916, 10 korrik 2015.

parlamentar, në qershor e patën një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në këtë takim u bisedua për procesin e transformimit të FSK-së në Forcat e Armatosura, si dhe për planet dhe përgatitjet për këtë proces. Këtu deputetët nga radhët e Grupit parlamentar 6+ u njoftuan, po ashtu, për planifikimet që janë bërë për kalimin në Ministri të Mbrojtjes dhe në Forca të Armatosura të Kosovës.[36]

Për më tepër, në mbledhjen e 22 prillit 2015, të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, përfaqësuesi i Grupit parlamentar 6+ shprehu qëndrimin e këtij Grupi për të votuar pro ligjit për shndërrimin e FSK-së në ushtri, sapo kjo të hidhet në Kuvend për votim. Mirëpo, përfaqësuesi i Grupit 6+ tërhoqi vërejtje në përfaqësimin e pjestarëve të këtij komuniteti, duke theksuar që ka probleme të mëdha në përfaqësim, meqë të dhënat nga raporti vjetor i FSK-së nuk përputhen me të dhënat që i ka ky komunitet[37].

Sidoqoftë, transformimi i FSK-së në FAK mbetet i ngujuar, meqë nuk ka kurrfarë treguesi që deputetët e Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës do ta votojnë një gjë të tillë, të paktën jo pa e shndërruar këtë çështje jetike për sigurinë e Kosovës në një pazarllëk politik me Beogradin.

Operimi i FSK-së në pjesën veriore të vendit dhe subordinimi ndaj autoriteteve civile

Menjeherë pasi që mori detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të Forcës për Sigurinë e Kosovës, gjeneral Rrahman Rama mori pjesë në takimin njoftues me Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ndër të tjera, Komandanti i FSK-së tregoi që kjo i ka patur dy kërkesa për kërkim-shpëtim, njëra prej të cilave kishte qenë për kërkim-shpëtimin e një të mituri që dyshohej të kishte rënë në lumin Ibër[38].

Intervenimi i FSK-së në Ibër u bë vetëm pasi komandanti i KFOR-it autorizoi njësitin e FSK-së për ta kryer operacionin e kërkim-shpëtimit. Dhënia e autorizimit ishte bazuar në një kërkesë zyrtare nga Policia e Kosovës, përkatësisht nga Shefi Rajonal për operim në veri, përmes Ministrisë së Punëve të

[36] MFSK. Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së Shkëlzen Sylaj priti deputetët e Grupit parlamentar gjashtë plus http://www.mksf-ks.org/?page=1,24,1353#.Vaog6_mqqko, Prishtinë, 4 qershor 2015.
[37] Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Mbledhja nr. 13, Prishtinë, 22 prill 2015, në orën 12:00.
[38] Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Mbledhja nr. 13, Prishtinë, 22 prill 2015, në orën 12:00.

Brendshme, duke u bazuar në kërkesën e prokurorit të rastit[39]. Kjo procedurë është e ndërlidhur edhe me zotimet e njëanshme të Qeverisë së Kosovës gjatë procesit të negociatave në Bruksel, për primatin e KFOR-it sa i përket sigurisë në veri vendit.

Lidhur me kryerjen e këtij lloji të operacioneve të FSK-së në veri të Kosovës, zyrtarë të NATO-s e kanë bërë të qartë që Kosova e ka marrë përsipër që trupat e FSK-së nuk do të zbarkohen në veri të Kosovës pa lejen parapake të NATO-s. Ata thanë që në kontekstin e marrëveshjes mes Prishtinës dhe Beogradit, të ndihmuar nga BE-ja, në prill të vitit 2013, Prishtina ka pranuar zyrtarisht që nuk do të zbarkojë trupat e FSK-së në veri pa lejen e KFOR-it. Po ashtu, kjo zyrë ka demantuar deklaratat e zyrtarëve serbë që ekziston një marrëveshje mes NATO-s dhe Serbisë që trupat e FSK-së, dhe, në të ardhmen, edhe të Forcave të Armatosura të Kosovës, nuk kanë të drejtë për t'u zbarkuar në komunat veriore.[40] Nga ana tjetër, edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, në një prononcim për media, më 1 prill 2015, theksoi që NATO-ja nuk është kundër asaj që Kosova t'i themelojë Forcat e Armatosura, dhe konfirmoi që është një pajtueshmëri me Aleancën Veri-Atlantike që në veri të vendit të mos shkohet pa marrëveshje me ta.[41]

Nga ana tjetër, në kundërshtim me këto deklarime të Kryeministrit të Kosovës dhe të zyrtarëve të NATO-s, Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral Rrahman Rama, në prill 2015 kishte deklaruar që FSK-ja nuk merr leje nga NATO-ja për të shkuar në veri të vendit, meqë, sipas tij, Ushtria e Kosovës do të veprojë aty ku e kërkon nevoja.[42] "Ne nuk imponohemi as në veri, as jug, e as në lindje dhe perëndim. Për këtë arsye dua edhe ta sqaroj se varësisht prej nevojave që i kanë qytetarët dhe nevojave që i ka shteti i Kosovës, ne do të veprojmë. Ne nuk marrim leje nga askush", ishte shprehur ai. Kjo deklaratë e Gjeneral Rrahman Ramës vë në pikëpyetje subordinimin e FSK-së ndaj autoriteteve civile të vendit, përkatësisht Kryeministrit të Kosovës, dhe si e tillë vë në dukje një deformim të thellë në qeverisjen demokratike të sektorit të sigurisë në Kosovë.

---

[39] KFOR: KSF DIVING UNIT TO OPERATE IN MITROVICA MUNICIPALITY http://www.aco.nato.int/kfor/news-room/press-releases/ksf-diving-unit-to-operate-in-mitrovica-municipality--.aspx, 11th April 2015.

[40] Telegrafi. NATO: Kosova ka pranuar, FSK në veri veç me lejen e KFOR-it. http://www.telegrafi.com/lajme/nato-kosova-ka-pranuar-fsk-ne-veri-vec-me-lejen-e-kfor-it-2-62424.html, 24 prill 2015.

[41] Mustafa: FAK-u Mund të Kalojë në Veri Vetëm me Lejen e NATO-s. http://live.kallxo.com/sq/MTL/Mustafa-FAK-u-Mund-te-Kaloje-ne-Veri-Vetem-me-Lejen-e-NATO-s-5803, 1 prill 2015.

[42] Gjeneral Rama: FSK s'ka nevojë të kërkojë leje për të shkuar në veri, http://www.telegrafi.com/lajme/gjeneral-rama-fsk-s-ka-nevoje-te-kerkoje-leje-per-te-shkuar-ne-veri-2-61296.html, 4 prill 2015.

Mbikëqyrja Parlamentare

Gjatë përiudhës së monitorimit, prill-korrik 2015, janë mbajtur gjithsej pesë mbledhje të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikqëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Lidhur me FSK-në veçohet mbledhja e datës 22 prill 2015, ku ishin të ftuar përfaqësues nga FSK-ja.[43]

Në këtë mbledhje, që kishte vetëm një pikë të rendit të ditës, atë të takimit me Komandantin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, deputeti Anton Quni shtroi çështjen e diskutimit të marrëveshjes së Qeverisë së kaluar të Kosovës me NATO-n lidhur me lejen për angazhimin e forcave të armatosura në veri të vendit, domethënë, shtrimin e kësaj teme në mes të autoriteteve të NATO-s dhe FSK-së, përfshirë këtu edhe ekzekutimin në aspektin praktik, procedurat e vendim-marrjes, procedurat e angazhimit, ato të kërkesave dhe të bashkëpunimit. Kësaj pyetjeje të deputetit Quni, Komandanti Rama iu përgjegj duke thënë se nuk ka asgjë zyrtare nga ana e NATO-s, duke shtuar që FSK-ja është në veri të Kosovës – pa e saktësuar ku, dhe se a ka bashkëpunim me KFOR-in, me dy kryetarët e komunave [Mitrovicë Jugore dhe Mitrovicë Veriore], me EULEX-in dhe me Policinë e Kosovës. Mirëpo, dhënia e autorizimit nga ana e KFOR-it për operacionin e kërkim-shpëtimit nga ana e FSK-së, më 11 prill 2015, tregon të kundërtën, domethënë, ekzistencën e procedurave për operacione në veri të vendit, dhe vë në dyshim të thellë deklaratën e Komandatit Rama që FSK-ja është në veri të vendit.

Për këtë arsye, është e nevojshme që Ministri i FSK-së të thirret në një seancë dëgjimore të Komisionit, ashtu që të sqarohen çështjet e subordinimit të Komandatit të FSK-së ndaj autoriteteve civile, përkatësisht ndaj Kryeministrit të Kosovës, si dhe deklaratat e tij problematike lidhur me praninë e FSK-së në veri që e nënkuptojnë mosekzistencën e procedurave për marrjen e autorizimit nga KFOR-i për zbatimin e operacioneve në këtë pjesë të vendit.

[43] Shih procesverbalin e mbledhjes se Komisionit:
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2015_04_22_12_5904_al.pdf

Besimi i qytatarëve në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ministrin e Forcës së Sigurisë dhe në Komisionin Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme, dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë

Nga këto tre institucione, në përgjithësi, qytetarët e Kosovës i besojnë më së shumti Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministri i Forcës së Sigurisë gëzon besimin e qytetarëve deri në një masë, që është pothuaj e njëjtë me atë të Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme, dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (KPSPBMFSK).



Në bazë të etnisë, FSK-ja gëzon besimin më të lartë te shqiptarët dhe komunitetet joshqiptare dhe joserbe. KPSPBMFSK, dhe Ministri i FSK-së gëzojnë besim deri dikund te shqiptarët dhe komunitetet joshqiptare dhe joserbe. Nga ana tjeter, komuniteti serb nuk ka besim fare në asnjërin nga këto tre institucione.



Shqiptarët që jetojnë në veri të vendit i besojnë më së shumti FSK-së, mirëpo mesatarja mbi bazat e vlerësimit të besimit këtu është me e ulët se mesatarja e besimit të shqiptarëve që jetojnë në pjesët e tjera të territorit të Kosovës. Po ashtu, shqiptarët që jetojnë në veri kanë besim më të ulët në Ministrin e FSK-së, dhe në KPSPBMFSK-në.



Te serbët e veriut dhe të jugut nuk shfaqet ndonjë dallim sa i përket besimit në këto tre institucioneve të Kosovës. Serbët nga këto dy pjesë nuk kanë besim fare, as në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, as në KPSPBMFSK, dhe as në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Sipas rajoneve, këto tre institucione besimin më të lartë e gëzojnë në Prizren dhe në Ferizaj. Nga këto tre institucione, është FSK-ja që e zë vendin e parë sa i përket besimit. Pos banorëve të veriut, që nuk besojnë fare në këto institucione, edhe banorët e Gjakovës kanë besim të ulët ndaj tyre. Po ashtu, nivel të ulët të besimit ka edhe komuna e Gjilanit.



Sipas etnive dhe rajoneve, shqiptarët dhe komunitetet joshqiptare dhe joserbe që banojnë në Ferizaj e kanë besimin më të lartë në FSK dhe në dy institucionet e tjera të sigurisë.



3. MONITORIMI I SEKTORIT TË INTELIGJENCËS

Hyrje

Gjatë periudhës prill–korrik 2015, çështja publike që i ka mbizotëruar zhvillimet në sektorin e inteligjencës ka qenë përleshja e armatosur në Kumanovë e 9 majit 2015, ku një numër i shtetasve të Kosovës mbetën të vrarë dhe shumë të tjerë u arrestuan.

Sipas njoftimeve të mediave, në fillim të vitit 2015, Agjencioni Kosovar i Inteligjencës (AKI) kishte përgatitur një raport të klasifikuar lidhur me aktivitetet e mundshme të jashtëligjshme të disa shtetasve të Kosovës në Maqedoni, dhe sipas deklaratave të kryetarit të Komisionit Parlamentar për Inteligjencë, z. Haxhi Shala, Presidenca, Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, anëtarët e komisionit, si dhe mekanizma të tjerë të sigurisë ishin njoftuar me kohë për mundësinë e ngarjeve që pasuan në Kumanovë. Mirëpo, këto pohime u mohuan shumë shpejt pas kësaj nga Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Brendshme.

Përleshja e armatosur në Kumanovë publikut ia ka bërë të ditur mangësitë serioze në reagimin e institucioneve të Kosovës, duke vënë në pah komunikimin e brishtë ndërinstitucional, mungesën e llogaridhënies, si dhe mungesën e bashkëpunimit përkatës midis institucioneve kompetente për çështjet e sigurisë shtetërore.

Raporti i kontestuar i AKI-së që e paralajmëronte përleshjen e armatosur në Maqedoni

Në përleshjen e armatosur të Kumanovës mbetën të vrarë 18 persona, 8 prej tyre policë, dhe 10 pjesëtarë të grupit të armatosur, ku, sipas Prokurorisë Publike të Maqedonisë, nëntë ishin shtetas të Kosovës[44] dhe njëri shtetas i Maqedonisë[45]. Ndërkaq, si pjesëtarë të këtij grupi të armatosur, u arrestuan 21 shtetas të Kosovës.[46] Kjo përleshje që, po ashtu, pati ndikim negativ në marrëdhëniet

[44] Kjo është lista zyrtare e të vrarëve në konfliktin e Kumanovës, telegrafi.com, 23 maj 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/kjo-eshte-lista-zyrtare-e-te-vrareve-ne-konfliktin-e-kumanoves-2-63854.html (qasur më 26 maj 2015).
[45] Pse ndryshoi numri i të vrarëve në Kumanovë?, evropaelire.com, 30 korrik 2015, http://www.evropaelire.org/content/article/27029060.html (qasur më 30 korrik 2015).
[46] Nga Kosova, 9 persona të vrarë dhe 21 të arrestuar në Kumanovë, telegrafi.com, 18 maj 2015,

bilaterale midis Prishtinës dhe Shkupit dhe në sigurinë rajonale, shkaktoi reagim të madh medial, dhe, po ashtu, nxiti debate të shumta në Kosovë.

Menjëherë pas fillimit të përleshjes së armatosur, Kryetari i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (KPMAKI), z. Haxhi Shala, në një prononcim për media theksoi se që në muajin shkurt – domethënë tre muaj para kësaj ngjarjeje – Agjencia Kosovare për Inteligjencë (AKI), përmes një raporti të klasifikuar kishte njoftuar Presidenten e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, Kryeministrin e Kosovës, z. Isa Mustafa, si dhe mekanizma të tjerë të sigurisë, për mundësinë që disa shtetas kosovarë të tentojnë ta destabilizojnë Maqedoninë.[47] Në këtë prononcim, z. Shala vuri në dijeni që ky raport i klasifikuar nuk u ishte dorëzuar anëtarëve të Komisionit në formë të shkruar, por që ata ishin njoftuar për të gojarisht nga zyrtarët e AKI-së.[48] Raporti i klasifikuar, pjesë të të cilit u botuan nga "Koha Ditore", përshkruante gjendjen jostabile në Maqedoni, dhe jipte skenarë të mundshëm të inskenimit të ndonjë akti terrorist në të cilin protagonistët do të ishin disa shqiptarë nga Kosova.[49] Me këtë u bë plotësisht e qartë që institucionet e sigurisë të Kosovës, edhe përkundrejt informimit me kohë nga AKI-ja[50], kishin dështuar për të vepruar me kohë dhe në mënyrë të koordinuar për ta shmangur përleshjen e Kumanovës.

Mirëpo, shumë shpejt pas kësaj, deklarata e Kryetarit të KPMAKI-së u mohua nga Kryeministri i Kosovës. Kryeministri Mustafa theksoi se "po qe se [Kryeministri i Republikës së Kosovës] do të dispononte informata të tilla, jo vetëm që me urgjencë do të kërkohej nga institucionet e sigurisë për t'i ndërmarrë të gjitha veprimet parandaluese, por një gjë e tillë do të kërkohej edhe nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë, me qëllim të parandalimit të humbjes së jetës së njerëzve dhe dëmtimit të pronës".[51] Këtë deklaratë të Kryetarit të KPMAKI-së e mohoi, po ashtu, edhe Ministri i Punëve të

---

http://www.telegrafi.com/lajme/nga-kosova-9-persona-te-vrare-dhe-21-te-arrestuar-ne-kumanove-2-63646.html (qasur më 20 maj 2015).

[47] AKI kishte informuar institucionet se po përgatitej inskenim i trazirave në Maqedoni, telegrafi.com, 12 maj 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/aki-kishte-informuar-institucionet-se-po-pergatitej-inskenim-i-trazirave-ne-maqedoni-2-63351.html (qasur më 14 maj 2015).

[48] Konfirmohet se Kosova kishte dijeni për incidentet në Maqedoni, telegrafi.com, 14 maj 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/konfirmohet-se-kosova-kishte-dijeni-per-incidentet-ne-maqedoni-video-2-63467.html (qasur më 14 maj 2015).

[49] AKI kishte informuar institucionet e Kosovës për inskenim të trazirave në Maqedoni, koha.net, 12 maj 2015, http://koha.net/index-28.11.2014.php?id=27&l=57148 (qasur më 13 maj 2015).

[50] "Kumanova", Qeveria fajëson AKI-në e Policinë, AKI-ja i vë fajin Qeverisë e Presidencës, koha.net, 19 maj 2015, http://koha.net/index-28.11.2014.php?id=27&l=58149 (qasur më 20 maj 2015).

[51] Komunikatë për media, Kryeministria e Republikës së Kosovës, 19 maj 2015, http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,4988 (qasur më 19 maj 2015).

Brendshme, Skender Hyseni, që theksoi se "[Policia dhe Ministria e Punëve të Brendshme] nuk kanë pranuar as edhe një informacion nga AKI".[52] Ndërkaq, Presidenca, përmes zëdhënësit, z. Arbër Vllahiu, u përmbajt, si nga pohimi, ashtu edhe nga mohimi, duke deklaruar që "këto janë informacione të klasifikuara, dhe prandaj nuk mund t'i komentojmë".[53]

Po ashtu, në Mbledhjen e 18 majit 2015 të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, znj. Aida Dërguti, Nënkryetare e Kuvendit të Kosovës, dhe, po ashtu, edhe anëtare e Komisionit për MPAKI, theksoi që menjëherë pas ngjarjeve në Kumanovë, AKI-ja këtij Komisioni i konfirmoi që me datën 23 shkurt të vitit 2015, "raporti për këtë grup i është dorëzuar Kryeministrit dhe Presidentes, ashtu siç e kanë obligim ligjor".[54] Në mbështetje të këtij konfirmimi doli edhe deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, z. Bekim Haxhiu, që pranoi se "institucionet e Kosovës kanë pasë informacione për grupin e armatosur".[55]

Dalja e raportit të klasifikuar në media

Dalja e raportit të klasifikuar të AKI-së të shkurtit 2015[56] në media, së bashku me deklarimet mbështetëse të Kryetarit të KPMAKI, z. Haxhi Shala, dhe deputetëve Dërguti dhe Haxhiu, hoqën dyshimet lidhur me ekzistencën e këtij raporti. Mirëpo, pyetja e parë që shtrohet këtu është si është e mundur që një raport i klasifikuar, që nuk u është dorëzuar madje as anëtarëve të KPMAKI-së në një formë të shkruar, e gjeti rrugën për në media?

Një rrjedhje të tillë të informacionit korniza ligjore e Kosovës e cilëson si vepër penale. Neni 34 i Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë parasheh që "zbulimi i informatave të klasifikuara të

---

[52] AKI s'e informoi MPB-në, për Kumanovën, telegrafi.com, 18 maj 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/aki-s-e-informoi-mpb-ne-per-kumanoven-2-63620.html (qasur më 19 maj 2015).
[53] Konfirmohet se Kosova kishte dijeni për incidentet në Maqedoni, telegrafi.com, 14 maj 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/konfirmohet-se-kosova-kishte-dijeni-per-incidentet-ne-maqedoni-video-2-63467.html (qasur më 14 maj 2015).
[54] Procesverbal i mbledhjes së komisionit për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të forcës së sigurisë së kosovës, fq. 7, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2015_05_18_10_5948_al.pdf (qasur më 27 maj 2015).
[55] Shala: Jahjaga, Mustafa e Hyseni i kanë njohur me emër e mbiemër grupin e armatosur të Kumanovës http://www.telegrafi.com/lajme/shala-jahajga-mustafa-e-hyseni-i-kane-njohur-me-emer-e-mbiemer-grupin-e-armatosur-te-kumanoves-2-63768.html (qasur më 28 maj 2015).
[56] "KONFIDENCIALE", zbatohet për informacionet, hapja e paautorizuar e të cilave do të mund t'i dëmtonte interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës. Shih Ligjin për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, neni 6, http://aki-rks.org/RKS/2010-178-alb.pdf (qasur më 3 prill 2015).

AKI-së cilitdo individ të pa autorizuar për ta pranuar atë, paraqet shkelje të Kodit Penal të Kosovës, dhe kryesi do t'i nënshtrohet dënimit siç parashihet në dispozitën përkatëse të kodit".[57]

Meqë ky "raport i kontestuar" i AKI-së, nominalisht është dashur t'u dorëzohet të paktën Presidencës, Kryeministrisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, atëherë shtrohet edhe pyetja e dytë, për atë se cili individ nga këto institucione bëri vepër penale duke vënë këtë raport të klasifikuar në dispozicion të mediave, ndërkaq, kjo e tëra hap rrugën edhe për pyetjen e tretë, lidhur me atë se a është ndërmarrë deri më tash ndonjë hetim lidhur me këtë rrjedje të informacionit të klasifikuar.

Mirëpo, mohimi i deritashëm i pranimit të këtij raporti nga ana e Kryeministrisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, e vështirëson hapjen e hetimeve të mirëfillta lidhur me këtë çështje, meqë në këtë situatë përgjegjësinë për rrjedhjen e tij në media a mban AKI-ja, që vërtetësinë e tij nuk e mohoi asnjëherë, madje as pas publikimit të tij në "Kohën Ditore".

Raporti i kontestuar: Korniza ligjore e bashkëpunimit dhe koordinimit Qeveri-AKI

Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, mes tjerash e specifikon edhe bashkëpunimin dhe koordinimin e Agjencionit të Kosovës për Inteligjencë me institucionet e tjera përkatëse, sa i përket çështjeve të sigurisë kombëtare.

Pikësëpari, bazuar në kompetencat dhe obligimet ligjore të Drejtorit të AKI-së, të specifikuara përmes nenit 5.7 të këtij Ligji, ai ju ofron Presidentit dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës informata lidhur me sigurinë, është përgjegjës për mbledhjen, analizën, prodhimin dhe shpërndarjen e informatave, dhe siguron që kjo të bëhet me kohë dhe në mënyrë objektive dhe të pandikuar nga arsyet politike. Prandaj, sipas kësaj dispozite ligjore, Drejtori i AKI-së ka qenë i obliguar që këtë raport të kontestuar t'ia dorëzojë Presidentes dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Domethënë, çështja e parë që duhet t'i sqarohet, si Komisionit Parlamentar për Siguri, ashtu edhe publikut, është ajo se a ua ka dërguar Drejtori i AKI-së raportin në fjalë këtyre dy institucioneve apo jo?

[57] Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L063_al.pdf (qasur më 5 prill 2015).

Nëse raportimi i AKI-së para Kryeministrit dhe Presidencës vërtetë nuk është bërë, a do të duhej që AKI-ja të jepte përgjegjësi për mospërmbushjen e këtij obligimi ligjor? Dhe, nga ana tjetër, nëse raporti është dorëzuar te këto dy institucione, pse nuk janë marrë masat e domosdoshme për ta parandaluar përleshjen e armatosur në Kumanovë?

Po ashtu, sipas nenit 5.7 të po të njëjtit Ligj, Drejtori i AKI-së "inicion dhe nënshkruan Memorandume të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me institucione dhe organe tjera", ndërkaq, sipas nenit 8.1 të tij, "bashkëpunimi ndërmjet AKI-së dhe Policisë së Kosovës, Ministrisë për Punë të Brendshme, si dhe me institucionet tjera të sigurisë publike është i rëndësisë primare". Më tutje, thuhet që "pas emërtimit të drejtorit të AKI-së, nënshkruhet një memorandum për bashkëpunim, ndihmë dhe koordinim të ndërsjellë të aktiviteteve ndërmjet AKI-së dhe Policisë së Kosovës (PK), Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe institucioneve tjera relevante qeveritare", si dhe që "AKI-ja dhe organet dhe institucionet tjera në Kosovë janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëra tjetrën në kryerjen e detyrave të tyre dhe të koordinojnë aktivitetet brenda kompetencave të veta, në harmoni me ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me mbrojtjen e burimeve, metodave dhe informacionit tjetër të klasifikuar"[58], gjë që implikon ligjërisht edhe ekzistencën e këtij memorandumi të bashkëpunimit, të ndihmës dhe koordinimit të ndërsjellë ndërmjet AKI-së, PK-së dhe MPB-së, e me këtë edhe e nënkupton në mënyrë të tërthortë vënien e raportit të kontestuar në dispozicion të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Kësisoj, kjo është çështja e dytë që duhet t'i sqarohet, si KPMAKI-së, ashtu edhe opinionit publik. Duke e presupozuar ekzistencën e memorandumit bashkëpunues ndërmjet AKI-së dhe Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, duhet hetuar vërtetësia e dorëzimit të raportit të AKI-së. Nëse MPB-ja dhe PK-ja e kanë marrë raportin nga AKI-ja, atëherë duhet të kërkohet, po ashtu, edhe llogaridhënia për mosreagimin e MPB-së dhe të PK-së në parandalimin e përleshjes së armatosur në Kumanovë.

Për më tepër, neni 25.2 parasheh që "nëse gjatë kryerjes së funksioneve të veta, AKI-ja bindet se ekziston bazë për dyshim se një person apo subjekt i caktuar ka kryer apo po kryen një vepër penale, apo po përgatitë apo organizon një vepër penale që i nënshtrohet ndjekjes penale, ajo është e obliguar të njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe prokurorin publik

[58] Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, neni 8.3.

kompetent".[59] Shikuar nga ky këndvështrim, pas zbulimit të aktiviteteve ilegale të shtetasve të Kosovës që përfunduan me përleshjen e armatosur në Kumanovë, AKI-ja është dashur ta njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe prokurorin publik kompetent, por jo domosdoshmërisht edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Rrjedhimisht, çështja e fundit që duhet sqaruar është ajo se a është kufizuar prezentimi i këtij raporti të AKI-së vetëm në Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së dhe në prokurorin publik kompetent.

Megjithatë, pavarësisht nga rezultatet e ndonjë hetimi eventual për sqarimin e çështjeve të sipërpërmendura, akuzat e ndërsjella dhe deklaratat kundërthënëse midis institucioneve ekzekutive dhe KPMAKI-së, rreth korrektësisë informuese dhe raportuese, lëjnë të nënkuptohet mundësia e mangësive serioze në menaxhimin e sektorit të sigurisë në Kosovë. Prandaj, është e domosdoshme që Kryeministri, Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, dhe Drejtori i AKI-së, të thirren në një seancë dëgjimore nga Komisioni për Mbikqyrjen e AKI-së për sqarimin e këtyre çështjeve. Po ashtu, Kryeministri i Kosovës, në bazë të kompetencave të veta ligjore duhet ta inicojë një hetim për rrjedhjen e raportit të klasifikuar në mediat e Kosovës. Sepse, rrjedhja e këtyre informacioneve do të ketë ndikim tejet negativ në kredibilitetin e Prishtinës në fushën e inteligjencës. Kosova nuk do të konsiderohet një partner kredibël nga partnerët ndërkombëtarë vendimtarë, dhe kjo gjithsesi do të ketë pasoja edhe në luftimin e rreziqeve transnacionale në vend.

Pos mangësive të sipërpërmendura, edhe më e rëndësishme është mosthirrja e mbledhjes së Këshillit të Sigurisë së Kosovës nga Kryeministri Mustafa, edhe përkundrejt deklarimit të tij publik se përleshja e armatosur në Kumanovë ka ndikuar edhe në marrëdhëniet bilaterale Kosovë-Maqedoni[60]. Po ashtu, edhe Presidentja Jahjaga, dhe edhe shumica e anëtarëve të përhershëm të këtij Këshilli, nuk e panë të arsyeshme asnjë herë që Kryeministrit t'i kërkonin formalisht thirrjen e një takimi të tillë[61], ku do të mund të diskutohej situata e krijuar, të vlerësohej gjendja e sigurisë në vend, dhe të mundësohej veprimi i koordinuar ndër-institucional.[62]

---

[59] Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.
[60]Mustafa: Kumanova ndikoi në marrëdhëniet tona me Maqedoninë, koha.net, 30 maj 2015, http://koha.net/?id=27&l=59794 (qasur më 30 maj 2015).
[61]Ligji Nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, neni 5.4, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L050_al.pdf (qasur më 6 prill 2015).
[62] Intervistë e KIPRED-it me një zyrtar të lartë të Qeverisë së Kosovës, më datën 24 korrik 2015.

Komisioni Parlamentar për Mbikqyrje të AKI-së

Që nga përleshja e armatosur në Kumanovë, Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e AKI-së është mbledhur vetëm dy herë[63] [64], dhe, nëse i shikojmë agjendat e këtyre mbledhjeve, përleshja e armatosur në Kumanovë nuk figuron askund si pikë diskutimi.

Krahas kësaj, KPMAKI-ja është duke çaluar në fushën e transparencës, meqë nuk ka dhënë kurrfarë informacioni as për çështjet që nuk janë domosdoshmërisht të klasifikuara, por që janë diskutuar në mbledhjet e tij, si, për shembull, për realizimin e planit të punës së Komisionit për tremujorin e parë 2015,[65] Shqyrtimin e sfidës së Raportit të Progresit 2014, në pjesët që ndërlidhen me fushëveprimin e Komisionit,[66] si dhe Shqyrtimin e realizimit të planit të punës së Komisionit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.[67]

Besimi i qytetarëve të Kosovës në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, në Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, dhe në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë

Me qëllim të matjes së besimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, në Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, dhe në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, KIPRED-i ka realizuar një hulumtim në terren.



[63] Shih: Takimet e KPMAKI, Kuvendi i republikës së Kosovës, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,131 (qasur më 11 prill 2015).
[64] Në mbledhjen e këtij komisionit të datës 30 qershor 2015 anëtarët e tij nga pozita nuk morën pjesë në takim, dhe në mungesë kuorumi raportimi dështoi, 30 qershor 2015, https://koha.net/?id=27&l=64442 (qasur më 30 qershor 2015).
[65] Shih: Agjenda e mbledhjes së KPMAKI e datës 08.04.2015, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,131 (qasur më 24 prill 2015).
[66] Shih: Agjenda e mbledhjes së KPMAKI e datës 22.04.2015, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,131 (qasur më 24 prill 2015).
[67] Shih: Agjenda e mbledhjes së KPMAKI e datës 22.07.2015, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,131 (qasur më 24 prill 2015).

Të anketuarit kanë patur mundësinë që nivelin e besimit që e kanë për institucionet apo krerët institucional ta shprehin me numra, dhe atë nga numri 1 deri në atë 5, ku me 1 vlerësohet niveli më i ulët i besimit, ndërkaq me 5 më i larti. Rezultatet e fituara janë të dhëna në vijim:

Sa i përket besimit të përgjithshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë gëzon besimin më të madh, por me një dallim fare të vogël nga Komisioni Parlamentar për AKI. Në fund, sa i përket besimit të qytetarëve, është Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.



Pyetja e njëjtë sa i përket besimit ndaj dy institucioneve që kanë të bëjnë me intelegjencën e Kosovës, si dhe me Drejtorin e AKI-së, u është shtruar edhe komuniteteve etnike të tjera të Kosovës, dhe besimin më të lartë e kanë komunitetet joshqiptare dhe joserbe, dhe atë posaçërisht në AKI. Më pas, komuniteti shqiptar ka besim përafërsisht mesatar në institucionet e paraqitura në tabelë, ndërkaq, komuniteti serb ka besim minimal.

Sa u përket shqiptarëve rezident në veri të Kosovës, ata besimin më të lartë e kanë në AKI, ndërkaq, besimi në Drejtorin e AKI-së dhe Komisionin Parlamentar për AKI është nën mesatare.



Ndër klasifikimet e kësaj matjeje të opinionit publik, është bërë edhe matja e besimit të serbëve që janë rezident në jug dhe në veri të Kosovës. Besimi i tyre ndaj AKI-së, Drejtorit të AKI-së dhe Komisionit Parlamentar për AKI e ka një nivel më të ulët. Pra, në që të tre pyetjet e shtruara, vlerësimi i besimit të komunitetit serb është minimal, pa dallim se në cilën pjesë të territorit të Kosovës jetojnë.

Lidhur me besimin sipas rajoneve të Kosovës, krahas besimit minimal në veri të Kosovës, Ferizaji dhe Prizreni i kanë dhënë vlerësimet më të larta. Po ashtu, krahasuar me rajonet e tjera të Kosovës, vërehet një besim nën mesatare në Gjakovë dhe në Gjilan, që ka vlerë nën 2.0.



Sa i përket besimit ndaj AKI-së, Drejtorit të AKI-së, dhe Komisionit Parlamentar për AKI, bazuar sipas rajoneve dhe etnive të Kosovës, komuniteti serb në Kosovë, pavarësisht vendndodhjes, e ka besimin minimal në tre opcionet e dhëna në sondazh. Ndërkaq, komunitetet tjera joshumicë në Kosovë, marrë në përgjithësi, kanë besim më të lartë në këto institucione, krahas komunitetit shumicë shqiptar në pothuaj të gjitha rajonet (pos në atë të Gjakovës).



Kur i shikojmë të gjitha rajonet, Ferizaji është ai me besimin më të lartë (pothuaj maksimal) në institucionet që kanë të bëjnë me inteligjencë dhe në Drejtorin e AKI-së, dhe atë pavarësisht përkatësisë etnike të të anketuarve. Nga ana tjetër, Gjakova është rajoni që, pavarësisht përkatësisë etnike, e ka besimin më të ulët ndaj institucioneve që janë të ndërlidhura me inteligjencën e Kosovës.


Besueshmëria sipas etnisë dhe rajonit
5.00
4.50
4.00
3.50
3.00
2.50
2.00
1.50
1.00
0.50
0.00
Prishtina
Mitrovica
Prizreni
Peja
Ferizaj
Gjakova
Gjilan
Total
Prishtina
Mitrovica
Peja
Ferizaj
Gjilan
Veriu i Kosovës
Prishtina
Mitrovica
Prizreni
Peja
Ferizaj
Gjakova
Shqiptar
Serb
Të tjerë
Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë
Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë
Komisionit Parlamentar për AKI

4. UDHËKRYQI I TRANSFORMIMIT TË FORCËS SË SIGURISË NË FORCAT E ARMATOSURA TË KOSOVËS: ÇFARË MË TUTJE

Hyrje

Ky punim analizon politikën e themelimit të Forcave të Armatosura të Kosovës, fizibilitetin e realizimit të mandatit të Forcave të Armatosura në raport me rreziqet dhe kërcënimet e mjedisit rajonal të sigurisë, dhe trajton çasjen e komunitetit serb të Kosovës si dhe të Serbisë ndaj krijimit të FAK-ut, si dhe rrugët e mundshme drejt themelimit të tij. Po ashtu, ky punim riaktualizon një pjesë të gjetjeve dhe të rekomandimeve të punimit të KIPRED-it "Kosova në kontekstin e sigurisë dhe mbrojtjes të Ballkanit", për shkak të validitetit të tij në rrethant e tashme.

Kosova si shtet i pavarur dhe sovran ka të drejtë të plotë për t'i patur forcat e veta të armatosura. E drejta natyrore e të gjitha shteteve për t'u vetëmbrojtur është përcaktuar qartë në Nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara,[68] që, si i tillë, nga kjo e drejtë nuk i përjashton shtetet joanëtare. Po ashtu, Karta e KB ndalon shfrytëzimin midis shteteve të forcave të armatosura (Neni 2.4),[69] dhe në mënyrë eksplicite e mbron çdo shtet nga shfrytëzimi i jashtëm i forcës, pavarësisht nga ajo se a e njohin shtetet në fjalë njëri-tjetrin dhe anëtarësinë e tyre në KB (kjo ka të bëjë me "çdo shtet").[70] Kësisoj, nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare, këto dispozita janë tërësisht të zbatueshme për të gjitha vendet e rajonit, përfshirë edhe Kosovën, pavarësisht nga fakti që ajo nuk është ende anëtare e KB.

Megjithatë, e drejta e Kosovës për vetëmbrojtje mbetet e parealizuar për shkak të bllokimit të procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë (FSK) në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK), që është pasojë e kundërshtimit të Listës Serbe, meqë formalizimi i këtij procesi kërkon votimin e 2/3 të përfaqësuesve të komuniteteve pakicë në Kuvendin e Kosovës në favor të ndryshimeve përkatëse

---

[68] Neni 51 i Kartës së KB: "Asgjë në këtë Kartë nuk do ta dobësojë të drejtën e qenësishme për vetëmbrojtje individuale apo kolektive nëse një sulm i armatosur ndodh kundër ndonjë Anëtari të Kombeve të Bashkuara, përderisa Këshilli i Sigurimit t'i ndërmerr masat e domosdoshme për ta mbajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Masat e ndërmarra nga Anëtarët në ushtrimin e kësaj të drejte të vetëmbrojtjes do t'i raportohen menjëherë Këshillit të Sigurimit dhe në asnjë mënyrë nuk do ta ndikojnë autoritetin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Sigurimit sipas kësaj Karte për ta ndërmarrë në çfarëdo kohe veprimin që e sheh si të domosdoshëm për ta mbajtur apo rivendosur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare."

[69] Neni 2(4): "Të gjithë Anëtarët do të përmbahen në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare nga kërcënimi apo shfrytëzimi i forcës kundër integritetit territorial apo pavarësisë politike të ***çdo shteti***, apo në çfarëdo mënyre që nuk është në pajtim me Qëllimet e Kombeve të Bashkuara."

[70] Për shpjegime të mëtutjeshme shih: Dr. René Värk: The Legal Framework of the Use of Armed Force Revisited, Baltic Security & Defence Review. Vëll. 15, Numri 1, 2013.

kushtetuese, përfshirë këtu edhe komunitetin serb. Kësisoj, duke patur parasysh varshmërinë e plotë të qëndrimeve të Listës Serbe nga Serbia, formalizimi i transformimit të FSK-së në FAK, faktikisht mbetet peng i gatishmërisë së Beogradit për të mos e penguar atë më tutje.

Për këtë arsye, procesi i transformimit të Forcës së Sigurisë në Forcat e Armatosura të Kosovës ka arritur në një udhëkryq, dhe hapat e mëtutjeshëm që do të ndërmirren nga institucionet e Kosovës do të jenë vendimtarë për mënyrën e përmbylljes së këtij procesi dhe për pasojat që do t'i ketë ai.

Politika e themelimit të Forcave të Armatosura të Kosovës

Propozimi për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës është rezultat i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) të Kosovës, që u inicua me vendimin 09/67 të Qeverisë së Republikës së Kosovës më 21 mars të vitit 2012[71]. Në bazë të këtij vendimi, RSSS-së ju përcaktuan këto qëllime:

- Definimi i Objektivave Strategjike të Kosovës dhe i Politikave të Sigurisë dhe Mbrojtjes të Republikës së Kosovës;
- Definimi në mënyrë adekuate i Ambientit Strategjik të Sigurisë, dhe i rreziqeve dhe kërcënimeve të mundshme të sigurisë;
- Analiza e plotë e kapaciteteve aktuale të institucioneve vendore të sigurisë;
- Përcaktimi i kapaciteteve që do t'u nevojiten institucioneve të sigurisë në të ardhmen;
- Dhënia e rekomandimeve për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme/të atyre që mungojnë, si dhe për shpërbërjen e atyre që nuk janë të nevojshme;
- Nxjerrja e një Strategjie të re të Sigurisë Kombëtare të Kosovës;
- Ndryshimi i kuadrit ligjor, në bazë të rekomandimeve të RSSS-së;
- Ndërtimi i institucioneve të sigurisë bazuar në rekomandimet e RSSS-së dhe Strategjisë Kombëtare të Sigurisë.

Me këtë vendim u emërua edhe Komiteti Drejtues i RSSS-së, në këtë përbërje: Ministri i Forcës së Sigurisë në kapacitetin e drejtuesit/kryesuesit, dhe, në cilësinë e anëtarëve, Ministri i Punëve të

[71] Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim për miratimin e nismës për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë, Prishtinë, 21 mars 2012

Brendshme, Ministri i Punëve të Jashtme, Drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Këshilltari për Siguri i Kryeministrit, Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe Drejtori i Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave. RSSS-ja është dashur ta përfundonte punën jo më vonë se në qershorin e vitit 2013.

Inicimi i RSSS-së ishte i ndërlidhur me përfundimin e dispozitave të përkohshme të Kushtetutës së Kosovës, përkatësisht, me përmbylljen e periudhës pesëvjeçare të "pavarësisë së mbikëqyrur", ashtu siç edhe ishte paraparë me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të të Dërguarit të Posaçëm të OKB-së, Presidentit Ahtisaari. Grupi Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën mbikëqyrjen e pavarësisë së Kosovës formalisht e përmbylli më 10 shtator 2012.

Megjithatë, emërimi i Komitetit Drejtues të RSSS-së dhe kryesimi i tij nga Ministri i FSK-së përplasen me kornizën ligjore të Kosovës, që mandatin për rekomandimin e politikave dhe të strategjive të sigurisë ia jep Këshillit të Sigurisë të Kosovës.[72] Mirëpo, nëse shikohet me kujdes përbërja e Komitetit Drejtues, vërehet që kjo është më e kufizuar në krahasim me Këshillin e Sigurisë, meqë anëtarë të tij nuk janë Kryeministri, zv. Kryeministrat, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri për Kthim dhe Komunitete. Po ashtu, për dallim nga Këshilli u Sigurisë, ku pjesëmarrja e të paktën një ministri nga komuniteti serb është e obligueshme[73], në përbërjen e Komitetit Drejtues nuk është asnjë anëtar nga ky komunitet. Në thelb, me vendimin e saj për miratimin e nismës për RSSS-në, Qeveria e Kosovës i mori, jashtë çdo kornize ligjore, ingerencat Këshillit të Sigurisë dhe i përjashtoi përfaqësuesit e komuniteteve pakicë nga ky proces. Po ashtu, vënia e Ministrit të FSK-së në krye të Komitetit Drejtues të RSSS-së, simbolizoi qëllimin parësor të tij, domethënë, prioritetin politik të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri/forcë të armatosur.

RSSS-ja u zhvillua paralelisht me dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Për këtë arsye, përfundimi i punës së RSSS-së u vonua për një vit, përkatësisht, Qeveria e Kosovës aprovoi Analizën dhe Rekomandimet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë më 4 mars 2014.[74] Megjithatë, implikimi i parë politik për zbatimin e RSSS-së ishte arritja e marrëveshjes

---

[72] Ligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë të Kosovës, No. 03/L-050, 13 mars 2008.
[73] *Ibid.*, Neni 3.2.
[74] http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analiza_e_Rishikimit_Strategjik_te_Sektorit_te_Sigurise_se_RKS_06032014.pdf

së parë për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, e 19 prillit 2014, që, në instancë të fundit, është bërë e mundshme vetëm përmes përfshirjes së NATO-s dhe dhënies së garancave Serbisë nga ana e Aleancës Veri-Atlantike dhe e Qeverisë së Kosovës, që FSK-ja nuk do të vendoset në komunat veriore të Kosovës.[75] Me dhënien e kësaj garance Qeveria e Kosovës bëri një lëshim në ushtrimin e sovranitetit në veri të vendit, pa marrë garanca nga Serbia që ajo nuk do ta pengonte krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, gjë kjo që e hapi rrugën për kushtëzime të mëtutjeshme nga pala serbe për themelimin e tyre. Po ashtu, kërkesa për dhënien e kësaj garance konfirmoi fuqishëm qasjen e Beogradit për një trajtim territorial, dhe jo përmbajtësor, të pozitës së komunitetit serb, duke patur parasysh faktin që pjesa më e madhe e këtij komuniteti nuk jeton në veri, por në pjesët e tjera të Kosovës.

Më 11 mars, 2014, Kryetari i Kuvendit të Kosovës ia dërgoi Gjykatës Kushtetuese amandamentet përkatëse të propozuara nga Qeveria e Kosovës, për ndryshimin e Kushtetutës në bazë të rekomandimeve të RSSS-së, përfshirë këtu edhe ato lidhur me themelimin e FAK-ut. Me vendimin e saj të datës 31 mars, 2014, Gjykata Kushtetuese vlerësoi pozitivisht ndryshimet e propozuara[76].

Mirëpo, votimi i amandamenteve në Kuvendin e Kosovës u shndërrua në peng të kushtëzimit të komuniteteve pakicë që, në shkëmbim për themelimin e FAK-ut, vendet e rezervuara t'i kenë edhe për një mandat. Për më tepër, madje edhe në këtë rast, votimi pro i deputetëve serb nuk ishte e garantuar, meqë ata edhe publikisht e bënë të qartë që nuk do ta përkrahin themelimin e FAK-ut.[77]

Dhënia e vendeve të rezervuara komuniteteve pakicë edhe për një mandat, në shkëmbim për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës u përkrah nga Partia Demokratike e Kosovës që asokohe e udhëhiqte qeverinë, mirëpo kjo u kundërshtua nga partitë opozitare. Edhe përkundrejt apeleve dërguar Kuvendit të Kosovës nga Qeveria e Kosovës[78], deputetët nuk pranuan që formimin e FAK-ut ta votojnë në të njëjtën pako me vendet e rezervuara për komunitetet pakicë. Pas kësaj, më

[75] Bisedë me një zyrtar te lartë të NATO-s, Bruksel, Maj 2013.
[76] Kushtetuesja pro transformimit të FSK në FAK, lajmi.net, 31 mars, 2014, http://lajmi.net/kushtetuesja-pro-transformimit-te-fsk-ne-fak_59681.html
[77] Shih p.sh. deklaratën e z. Petar Miletic, ish-nënkryetar i Kuvendit të Kosovës nga komuniteti serb të 28 prillit 2014, "Srbi nece podrzati amandmane na Ustav Kosova", www.vesti-online.com, http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/399565/Srbi-nece-podrzati-amandmane-na-Ustav-Kosova
[78] Qeveria i Kërkon Kuvendit formimin e FAK-ut, GazetaExpress, 3 Prill 2014.

7 maj 2014, Kuvendi i Kosovës u shpërbë dhe vendi shkoi në zgjedhje të përgjithshme, pa e përfunduar formalizimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Nga ana tjetër, NATO-ja në mënyrë të heshtur, dhe me përkrahje të hapur të SHBA-ve, e dha dritën e gjelbër për transformimit e FSK-së në FAK, mirëpo, duke e bërë të qartë që për këtë duhet edhe vota pro e minoriteteve.[79] Mirëpo, Serbia e kundërshtoi ashpër krijimin e FAK-ut, dhe këtë çështje Presidenti Nikoliq e ngriti edhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në mbledhjen e 27 majit 2014.[80]

Me këtë akt të Serbisë u bë e qartë që formalizimi i themelimit të Forcave të Armatosura të Kosovës përmes amandamentimeve të domosdoshme të Kushtetutës do të jetë pothuaj i pamundur në rrethanat e tashme, meqë për ta arritur këtë nevojiten edhe votat e 2/3 të komuniteteve pakicë, përfshirë këtu edhe deputetët e komunitetit serb, në Kuvendin e Kosovës. Ky qëndrim kundërshtues i Beogradit ndaj krijimit të FAK-ut, u formalizua shumë shpejtë edhe në vendim-marrjen kosovare përmes partnerit të Koalicionit Qeveritar PDK-LDK, Listës Serbe, që e bëri të ditur se shndërrimi i FSK-së në FAK nuk është i pranueshëm dhe se ky qëndrim nuk do të ndryshojë në kurrfarë rrethanash[81].

Edhe përkundrejt këtij qëndrimi të Listës Serbe, më 27 maj 2015, Qeveria e Kosovës i procedoi në Kuvendin e Kosovës amandementet për ndryshimet kushtetuese për Themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës[82]. Mirëpo, kundër këtyre amandamenteve votuan dy anëtarët e Qeverisë së Kosovës nga Lista Serbe[83]. Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, zv.Kryeministri nga komuniteti serb, z. Branimir Stojanoviq, theksoi që transformimi i FSK-së në FAK është i papranueshëm për popullatën serbe, para së gjithash meqë është kërkuar diskutimi i kësaj teme, dhe ai nuk është bërë fare, dhe, po ashtu, meqë forcat e armatosura mono-etnike, të përbëra nga komuniteti shumicë,

---

[79] USA backs the creation of the Armed Forces of Kosovo, Independent Balkans News Agency, 29 prill 2014, http://www.balkaneu.com/22877/

[80] Apel i Presidentit Nikolic për Këshillin e Sigurimit të KB, uebsajti zyrtar i Presidentit të Serbisë http://www.predsednik.rs/en/press-center/press-releases/appeal-president-nikolic-un-security-council, 27 maj, 2014.

[81] Lista Serbe kundër Forcave të Armatosura të Kosovës. Telegrafi.com, 13 dhjetor, 2014, http://www.telegrafi.com/lajme/lista-serbe-kunder-forcave-te-armatosura-te-kosoves-2-55291.html

[82] http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_31-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2015_(2).pdf

[83] Kosova ndryshon Kushtetutën për Forcat e Armatosura, Lajmifundit.al, 27 maj 2015, http://lajmifundit.al/2015/05/kosova-ndryshon-kushtetuten-per-forcat-e-armatosura/

komuniteti serb i përjeton si një kërcënim dhe rrezik latent për tërë rajonin[84]. Kësisoj, tash është bërë plotësisht e qartë që pa përkrahjen e Serbisë, gjasat për formalizimin e themelimit të Forcave të Armatosura të Kosovës janë fare të vogla, dhe, po ashtu, mbetet i paqartë çmimi që duhet paguar nga pala kosovare për përmbushjen e tij.

Komisioni Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, për Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencionit Antikorrupsion, i aprovoi amandamentet kushtetuese të propozuara nga Qeveria më 10 korrik 2015.[85] Mirëpo, për shkak të rrezikut të mos-votimit të këtyre amandamenteve nga ana e deputetëve të komunitetit serb, Kryesia e Kuvendit të Kosovës, më 20 korrik, e hoqi nga rendi i ditës votimin e tyre në seancë plenare.[86]

Në këtë mënyrë, mos-menaxhimi i duhur i procesit politik dhe institucional të themelimit të FAK-ut nga Qeveria e Kosovës, e cila fillimisht e përjashtoi nga ky proces Këshillin e Sigurisë, dhe me këtë edhe ministrat e komunitetit serb nga procesi i RSSS-së dhe rrjedhimisht edhe nga procesi i transformimit të FSK-së në FAK, dhe, po ashtu, dha garanca për mos-vendosjen e FSK-së në veri të vendit, pa marrë kurrfarë garancash kthyese për mospengimin e krijimit të FAK-ut, e ka sjellur në udhëkryq themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Mundësia e realizimit të mandatit të Forcave të Armatosura në raport me rreziqet dhe kërcënimet e mjedisit rajonal të sigurisë

Vlerësimet e kërcënimeve dhe të rreziqeve (ndikimi i vlerësuar negativ, përballë gjasës së tyre) shfrytëzohen nga qeveritë për t'i përcaktuar përgjegjësitë në menaxhimin e rrezikut,[87]përfshirë këtu planifikimin për situatat e paparashikuara. Meqë, sipas propozimit për ndryshimet kushtetuese, përkatësisht, Nenit 126 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mandati i paraparë i Forcave të Armatosura është mbrotja e sovranitetit, e integritetit territorial, e qytetarëve, pronës, dhe e interesave të Republikës së Kosovës, si dhe dhënia e kontributit për ndërtimin dhe ruajtjen e

---

[84] Oruzane Snage Kosova neprihvatljive za Srbe, Blic.rs, 27 maj 2015, http://www.blic.rs/Vesti/Politika/562674/StojanovicOruzane-snage-Kosova-neprihvatljive-za-Srbe
[85] http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,123
[86] Këto janë kushtet e Listës Serbe për Ushtrinë e Kosovës, Telegrafi.com, 20 korrik 2015, http://www.telegrafi.com/lajme/keto-jane-kushtet-e-listes-serbe-per-ushtrine-e-kosoves-2-67230.html
[87] Todor Tagerev: "The Art of Shaping Defence Policy: Scope, Components, Relationships (but no Algorithms)," Connections, Vëllimi V, Numri 1, Pranverë – Verë 2006, fq.33.

stabilitetit rajonal dhe global, atëherë, në vazhdim do ta analizojmë korrektësinë e vlerësimeve të rreziqeve dhe të kërcënimeve të sigurisë të mjedisit rajonal, dhe do t'i hetojmë shkaqet e mundshme politike për mostrajtimin e hapur të tyre.

RSSS-ja mjedisin rajonal të sigurisë e trajton si shumë më të favorshëm në krahasim me kohën kur është shpallur pavarësia e Kosovës, dhe për këtë i jep kredi të veçantë "relaksimit dhe normalizimit të marrëdhënieve në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, e cila ka filluar dhe është duke e vazhduar në frymën e moskonfrontimit dhe integrimit Evropian".[88] RSSS-ja vlerëson që rreziqet dhe kërcënimet rajonale janë shpërndarja e armëve të vogla, ekstremizmi etnik dhe fetar, krimi i organizuar, përshirë edhe trafikimin, krimet ekonomike, proliferimi i armëve të shkatërrimit masiv, jostabiliteti politik rajonal, epidemitë dhe katastrofat natyrore.[89]

Mirëpo, nëse analizojmë politikat e sigurisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, mund të verejmë që të gjitha shtetet e rajonit, me përjashtim të Serbisë, kërcënimet e natyrës konvencionale i paraqesin pa e përmendur ndonjë vend të veçantë si brengë apo kërcënim të drejtpërdrejtë[90]. Serbia e paraqet Kosovën si rrezik të separatizmit[91], terrorizmit, krimit të organizuar, korrupcionit dhe trafikimit të drogës, armëve dhe qenieve njerëzore[92], ndërkaq, Forcën e saj të Sigurisë (KSF) e konsideron si një kërcënim të drejtpërdrejtë "ndaj strukturës ekzistuese rajonale të kontrollit të armatimit, që e kërcënon barazpeshën në rajon".[93] Po ashtu, në mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të saj territorial, Serbia është e vendosur të përdorë të gjitha mjetet diplomatike, ligjore dhe mjetet e tjera legjitime[94], duke e bërë të ditur në mënyrë implicite që ajo nuk e përjashton as shfrytëzimin e forcës. Fjalori që Beogradi e përdor lidhur me krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës është madje edhe më i vrazhdë[95]. Projektimi i Kosovës si një kërcënim kaq i madh ndaj sigurisë, i tregon haptas synimet e sigurisë dhe të mbrojtjes së Beogradit kundër Prishtinës, dhe posaçërisht ndaj krijimit të FAK-ut.

---

[88] Qeveria e Republikës së Kosovës, "Analizë e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë të Republikës së Kosovës", mars 2014, f. 16.
[89] *Ibid.* f. 17.
[90] Lulzim Peci, "Kosova në kontekstin e sigurisë dhe mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor", KIPRED, shtator 2014, f. 11.
[91] National Security Strategy of Serbia, Beograd Tetor, 2009 f. 6.
[92] *Ibid* f. 7.
[93] *Ibid.* f. 10.
[94] *Ibid* f. f. 17.
[95] Shih, për shembull, deklarimin e Ministrit të Mbrojtjes së Serbisë, Bratislav Gasic: Vojska Kosova bi bila pretnja, http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2014&mm=07&dd=27&nav_category=640&nav_id=881519, News Agency B92, 27 korrik, 2014.

Përderisa Serbia ka kapacitete ushtarake kredibile, dhe atë jo vetëm defansive, por edhe ofansive, Kosova nuk e posedon asnjërin prej tyre[96], gjë kjo që atë, në mungesë të prezencës ushtarake të NATO-s, e bën praktikisht të pambrojtur. Për më tepër, krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës nuk do ta ketë ndonjë rol domethënës sa i përket balancit rajonal ushtarak, dhe si i tillë nuk e paraqet ndonjë kërcënim ushtarak për cilindo nga fqinjët e Kosovës.

Në pajtim me politikën e vet të mosnjohjes, Serbia e ka projektuar Kosovën si kërcënimin kryesor të sigurisë në pothuaj të gjitha aspektet, përfshirë këtu edhe atë ushtarak. Nga ana tjetër, Kosova formalisht – por, po ashtu, edhe jorealisht – ka vendosur që Serbinë të mos e konsiderojë si të tillë. Kjo zgjedhje politike e Kosovës mund të ketë qenë rezultat i: (a) mendimit të udhëhequr nga dëshirat dhe mosnjohuritë[97], (b) mbrojtjes së ofruar nga KFOR/NATO, që e zhduk frikën ekzistuese, apo (c) sygjerimeve të dhëna nga disa nga qeveritë perëndimore që e përkrahin shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK)[98].

Mirëpo, kjo zgjedhje nuk e zgjidh këtë problem vetvetiu, pavarësisht nga "detanti i brishtë" midis Kosovës dhe Serbisë, që është rezultat i dialogut të ndihmuar nga Unioni Evropian. Për më tepër, çfarëdo përpjekje e Kosovës për balancim të fortë ushtarak me Serbinë nuk është fizibile në aspektin ekonomik, pasi që kjo do të çonte në falimentimin e vendit, ndërkaq, në aspektin politik, do të kishte për pasojë përshkallëzimin e tensioneve ndëretnike, si dhe izolimin e saj ndërkombëtar, për shkak të mos-tolerimit nga NATO-ja dhe SHBA-të të ndonjë nisme për armatim absurd të Kosovës.

A është krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës në interesin e komunitetit serb në Kosovë dhe të Serbisë[99]?

Edhe pse në shikim të parë kjo mund të duket paradoksale, konsolidimi i arkitekturës së sigurisë së Kosovës, në thelb është në interesin e Serbisë. Së pari, meqë kjo do ta hapte rrugën që Kosova të ndërtojë marrëdhënie partneriteti me NATO-n, gjë kjo që, më tutje, do ta mundësonte zhvillimin e

[96] The Military Balance 2014, International Institute for Strategic Studies, London, janar 2014, fq. 132-133.
[97] Intervistë me një zyrtar të lartë të Ministrisë së FSK-së, 18 nëntor, 2014.
[98] Intervistë me një zyrtar të lartë të Zyres për Planifikim Strategjik pranë Zyres së Kryeministrit të Kosovës, 4 tetor 2014.
[99] Kjo pjesë e punimit, për shkak të nevojave analitike të këtushme është kompiluar nga punimi i mëhershëm i KIPRED-it "Kosova në kontekstin e sigurisë dhe mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor".

FAK-ut nën udhëheqjen e Aleancës. Si një vend që aspiron anëtarësimin në Aleancë, Kosova në këtë mënyrë nuk do të kishte, madje as gjasa teorike për ta ndërtuar ndonjë ushtri kërcënuese, apo për të ndërmarrë çfarëdo veprimesh armiqësore kundër Beogradit.

Së dyti, pjesëmarrja e serbëve lokalë në Forcat e Armatosura multi-etnike të Kosovës do ta krijonte besimin e pjesëtarëve të komunitetit serb në këto forca. Po ashtu, oficerët e komunitetit serb do të merrnin pjesë në planifikimin mbrojtës, dhe, në një kësi situate, është e paparamendueshme që ata do të pajtoheshin me çfarëdo qoftë planifikimi, apo që do të bindeshin të zbatonin çfarëdo qoftë urdhërash, në rast se këto do të ishin armiqësore ndaj Serbisë.

Dhe, së treti, përmes bashkëpunimit mbrojtës me Kosovën, Serbia, si anëtare e Partneritetit për Paqe (PfP), dhe si një vend që aspiron të integrohet në mekanizmat e Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, mund ta japë kontributin e vet për përmbylljen e kapitullit të fundit të pambyllur të sigurisë dhe të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Ky bashkëpunim do t'i ndihmonte rajonit për të evoluuar në drejtimin e një komuniteti të sigurisë, të ngjashëm me atë të vendeve nordike, që i bën bashkë NATO-n dhe shtetet anëtare neutrale të PfP-së.

Prandaj, logjikisht mund të konkludohet që krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës nuk i cenon interesat e Serbisë dhe nuk paraqet kurrfarë kërcënimi për komunitetin serb të Kosovës. Mirëpo, për ta arritur këtë, duhet të sigurohet përfaqësimi adekuat i oficerëve serbë në Forcat e Armatosura të Kosovës, si dhe trajtimi jo-armiqësor i FAK-ut nga Serbia.

Përfshirja e pjesëtarëve të komunitetit serb në Forcën e Sigurisë të Kosovës mbetet tejet e ulët (1,83%),[100] dhe kryesisht për shkak të kundërshtimit dhe ndikimit negativ të Beogradit. Sidoqoftë, pavarësisht nga ajo që njëri nga postet e Zëvendësministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës i takon përfaqësuesit politik të komunitetit serb, nuk ka kurfarë justifikimi për atë që grada më e lartë e një oficeri serb në FSK është ajo e oficerit në krijim.[101] Kjo çështje duhet të adresohet me seriozitetin më të madh nga ana e Qeverisë së Kosovës.

---

[100] Donika Emini, "Inclusion or Exclusion? Minorities in the Security Sector in Post-Independence Kosovo", Kosovo Center for Security Studies, http://www.qkss.org/repository/docs/Inclusion_or_Exclusion_Minorities_In_The_Security_Sector_In_PostIndependent_Kosovo_223772.pdf, mars 2014, fq.17.

[101] Intervistë e KIPRED-it me KFOR-in francez, gusht 2014.

Po ashtu, ndryshimi i politikave të sigurisë dhe të mbrojtjes së Serbisë – të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë dhe të Strategjisë së Mbrojtjes – në raport me Kosovën, mund ta ketë një ndikim të madh në uljen e mosbesimit dhe armiqësive të tashme, dhe ky veprim do ta hapte rrugën e një bashkëpunimi dhe partneriteti të mirëfilltë të ardhshëm midis dy vendeve në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes, si dhe të integrimit të mirëfilltë të komunitetit serb në FAK. Integrimi i mirëfilltë i komunitetit serb në FSK apo në FAK është pothuaj i pamundur, përderisa vendi amë i tyre të vazhdojë t'i trajtojë këto dyjat në mënyrë armiqësore.

Themelimi i FAK-ut: Çfarë më tutje?

Themelimi i Forcave të Armatosura të Kosovës është në një udhëkryq me rrugë të panjohura, dhe cilado anë që zgjidhet për të ecur më tutje do të jetë, edhe e rëndë, edhe e vështirë për t'u parashikuar. Sidoqoftë, opcionet e vetme për të ecur përpara me procesin e transfomimit të FSK-së në FAK, janë hapja e diskutimit me Listën Serbe, hapja e kësaj teme në dialogun e Brukselit midis Kosovës dhe Serbisë, apo shtyrja e themelimit nominal të FAK-ut për një kohë të pacaktuar, në të cilin rast në vend të themelimit të FAK-ut do të procedohej ligji i ri për FSK-në.

Hapja e diskutimit me Listën Serbe nga ana e partnerëve qeveritarë, padyshim që nuk do të kufizohet vetëm në themelimin e FAK-ut, por do të zgjerohet edhe me tema të tjera që kanë të bëjnë me përmbushjen e marrëveshjes së koalicionit qeveritar midis PDK-LDK dhe Listës Serbe, të 9 dhjetorit 2014[102], si dhe me përfaqësimin e komunitetit serb në institucionet e sigurisë së Kosovës.
Mirëpo, ashtu siç edhe u tha më sipër, gama e çështjeve që mund të ngriten gjatë diskutimit nga ana e Listës Serbe, ka gjasë të jetë shumë më e gjërë, meqë themelimi i FAK-ut trajtohet si çështje jetike, jo vetëm për partnerët e koalicionit qeveritar, domethënë PDK-në dhe LDK-në, por, po ashtu, edhe për opozitën. Lista Serbe është e vetëdijshme që interesat e partive politike të shqiptarëve për krjimin e FAK-ut janë tejet të larta, ndërkohë që ajo tash nuk ka kurrfarë interesi për themelimin e tij, por, përkundrazi, do ta ketë për qëllim bllokimin edhe për shkak të qëndrimit negativ të Serbisë. Nga ana tjetër, opcioni për ta futur në pako themelimin e FAK-ut së bashku me çështjen e Asociacionit të Komunave Serbe nga ana e PDK-së dhe LDK-së, ka pak gjasa të jetë fizibil, meqë, nga njëra anë,

[102] Teksti origjinal i marrëveshjes: http://www.zeri.info/aktuale/10331/ekskluzive-marreveshja-pdk-ldk-lista-srpska-dokument/

arritja e marrëveshjes për Asociacionin është në fazën e fundit, dhe, nga ana tjetër, ky është edhe obligim ndërkombëtar i Kosovës që rrjedh nga Marrëveshja e 19 prillit 2013.

Opcioni i dytë është ai i hapjes së dialogut për këtë çështje në Bruksel. Mirëpo, duke patur parasysh fazën e tashme të dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit, vështirë që mund të ketë hapsirë që themelimi i FAK-ut të futet në agjendën e çështjeve për të cilat pritet marrëveshja, meqë kjo, tash për tash është pothuaj e mbyllur.

Duke patur parasysh detantin e brishtë të marrëdhënieve mes dy vendeve, hapja e ndonjë dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit për FAK-un, dhe çfarëdo qoftë marrëveshje që do të mund të arrihej lidhur me këtë, do të ishte parciale pa adresimin edhe të masave të ndërtimit të besimit në fushën e mbrotjes midis Kosovës dhe Serbisë. Hapja e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë lidhur me masat për ndërtimin e besimit mbrojtës, është një hap i domosdoshëm drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve midis dy vendeve[103].

Mirëpo, hapja e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë për ndërtimin e masave të besimit në fushën e mbrojtjes duhet të pret për një kohë të gjatë, dhe atë ndoshta fazën e fundit të negociimit të Kapitullit 35 të *Acquis*-it në procesin e bisedimeve për akcesion midis BE-së dhe Serbisë, që ka të bëjë kryekëput me Kosovën. Kësisoj, ky opcion do ta nënkuptonte heqjen nga agjenda të themelimit të FAK-ut për një kohë të pacaktuar.

Duke i patur parashysh rrethanat e tashme, opcioni më real është ai i shtyrjes së themelimit të FAK-ut për një kohë të pacaktuar, ashtu që në vend të kësaj të procedohet një ligj i ri për FSK-në. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e pengon FSK-në që ta forcojë mandatin e vet[104], dhe që praktikisht të shndërrohet në forcë të armatosur, pa e ndërruar, tash për tash emrin e vet, dhe që në aspektin operacional ta bëjë transformimin e vet, ashtu siç edhe është paraparë me Analizën e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë[105]. Një opcion i tillë, praktikisht, do ta shndërronte FSK-në në FAK, dhe njëkohësisht do ta eliminonte mundësinë e bllokimit të themelimit të FAK-ut nga Beogradi

[103] Për detaje shih: Lulzim Peci, "Kosova në kontekstin e sigurisë dhe mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor", shtator 2014.
[104] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 126 [Forca e Sigurisë së Kosovës]. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf
[105] Analiza e Rishikimit të Sektorit të Sigurise [pika 7.1.3, Ministria e Forcës së Sigurisë], http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analiza_e_Rishikimit_Strategjik_te_Sektorit_te_Sigurise_se_RKS_06032014.pdf

përmes Listës Serbe. Futja e sërishme në agjendë e themelimit formal të FAK-ut mund të shtyhet deri në një moment të përshtatshëm, të koordinuar me NATO-n, gjatë procesit të negociatave të Kapitullit të 35 të *Acqui*s-it midis BE-së dhe Serbisë.

Konkluzione dhe Rekomandime

Mosmenaxhimi i duhur i procesit politik dhe institucional të themelimit të FAK-ut nga Qeveria e Kosovës, që fillimisht e përjashtoi nga ky proces Këshillin e Sigurisë, dhe me këtë edhe ministrat e komunitetit serb nga procesi i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe të vetë transformimit të FSK-së në FAK, dhe që, më pas, dha garanca për mos-vendosjen e FSK-së në veri të vendit, pa marrë garanca kthyese për mospengimin e krijimit të FAK-ut nga ana e Serbisë, themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës e ka sjellur në një udhëkryq.

Krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës nuk do ta ketë ndonjë rol domethënës sa i përket balancit rajonal ushtarak, dhe si i tillë, ky nuk paraqet ndonjë kërcënim ushtarak për cilindo nga fqinjët e Kosovës.

Themelimi i Forcave të Armatosura të Kosovës dhe forcimi i karakterit multietnik të këtij institucioni, përfshirë këtu edhe rezervimin e një numri të pozitave udhëheqëse për oficerët e komunitetit serb, është në interesin e këtij komuniteti dhe të vetë Serbisë.
Qeveria e Kosovës ka para vetes tre opcione për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, dhe atë hapjen e dialogut me Listën Serbe, hapjen e dialogut në Bruksel, dhe ndryshimin e Ligjit për FSK-në.

Duke patur parasysh bllokadën e Listës Serbe për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, dhe kundërshtimin këmbëngulës të Serbisë, nga njëra anë, si dhe momentin e tashëm të papërshtatshëm për hapjen e kësaj teme në Bruksel, nga ana tjetër, opcioni më real mbetet ndryshimi i Ligjit për FSK-në, me ç'rast ky institucion, pa e ndërruar emrin, do të fuqizohej për sa i përket mandatit, fushës së veprimtarisë, si dhe strukturës së vet, dhe në aspektin operacional do ta bënte transformimin e vet, ashtu siç edhe është paraparë në Analizën Strategjike të Sektorit të Sigurisë të Kosovës.

Momentumi i përshtatshëm për hapjen e dialogut për ndërtimin e masave të besimit në fushën e mbrojtjes midis Kosovës dhe Serbisë, si dhe të futjes së sërishme në agjendë politike të themelimit të FAK-ut, mund të krijohet gjatë negociatave të Kapitullit 35 të *Acquis*-it midis BE-së dhe Serbisë.

5. PASQYRË E SHKURTËR ANALITIKE E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK

Në anketë kanë marrë pjesë 1.000 respondentë që janë përgjegjur në pyetjen: "Na tregoni, sa u besoni institucioneve të mëposhtme lidhur me çështjet e sigurisë?", ndërkaq, institucionet e dhëna janë: 1) Presidentja; 2) Kryeministri; 3) Ministri i Punëve të Brendshme; 4) Policia e Kosovës; 5) Komisioni Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës; 6) Ministri i Forcës së Sigurisë; 7) Forca e Sigurisë së Kosovës; 8) Agjencia e Inteligjencës e Kosovës; 9) Drejtori i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës; dhe, 10) Komisioni Parlamentar për Inteligjencë. Vlerësimi i besimit është bërë nga nota më e ulët, 1, deri në notën më të lartë, 5, dhe margjina e gabimit ka qenë ±3%.

Respondentët janë ndarë në grupe të ndryshme, dhe janë shikuar vlerësimet e këtyre grupeve. Këto grupe janë ndarë sipas: etnisë dhe vendit në Kosovë ku këto etni jetojnë (serbët e veriut, të jugut, shqiptarët e veriut), vendbanimit (urbane, rurale), gjinisë, grupmoshës, edukimit, punësimit, etnisë, rajonit, dhe etnisë sipas rajoneve.

Çështjet më të rëndësishme, dhe më interesante që dalin nga kjo anketë janë të dhëna në vijim:

Dy notat më të larta u janë dhënë FSK-së (4.00) dhe Policisë së Kosovës (3.79); ndërkaq, dy notat më të ulëta u janë dhënë Kryeministrit (2.67) dhe Ministrit të Punëve të Brendshme (2.75).

Te shqiptarët që jetojnë në veriun e Kosovës, dy notat më të larta kanë qenë për FSK-në (3.80) (që, përndryshe, nuk e kanë brenda veriut të Kosovës) dhe për Policinë e Kosovës (3.50), ndërkaq, dy notat më të ulëta këta i kanë për Ministrin e Punëve të Brendshme (2.13) dhe për Kryeministrin (2.20). Nga këto të dhëna del një pyetje interesante që kërkon përgjigje, ajo se si mund të vlerësohet nga banorët e veriut më së larti një institucion i sigurisë që nuk vepron në pjesën veriore të vendit?

Te serbët dy notat më të larta i kanë Policia e Kosovës 1.82 (serbët e veriut: 1.54, dhe serbët poshtë lumit Ibër 1.99), dhe Presidentja, 1.06 (serbët e veriut, 1.04, dhe serbët poshtë Ibrit, 1.07). Të gjitha

institucionet e sipërpërmendura, pos Presidentes, Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, nga serbët janë vlerësuar me notën më të ulët, 1.0.

Popullata rurale e ka patur një prirje për të shprehur besim më të lartë në institucionet e sipërpërmendura, se popullata urbane. Besimi i shprehur në këto institucione nga dy gjinitë ka qenë i përzier, mirëpo, dallimet midis dy gjinive kanë qenë fare të vogla. Te variabla e moshës dhe ajo e edukimit, nuk ka patur ndryshime në besimet e shprehura në këto institucione që do të indikonin dukuri të veçanta.

Te grupet e të punësuarve, vërehet që besimin më të lartë në institucionet e përmendura e kanë amviset, ndërkaq, besimin më të ulët e kanë të punësuarit në sektorin publik (dhe, fare pak mbi ta, kategoria e të vetëpunësuarve). Kësisoj, edhe pse të punësuarit në sektorin publik e kanë, njësoj si edhe kategoritë e tjera të të punësuarve (dhe e të papunëve), besimin më të lartë për Policinë e Kosovës dhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës, këta janë e vetmja kategori në variablën e punësimit, që këto institucione i kanë vlerësuar me notë nën 3.0 (Policia e Kosovës, 2.92, dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, 2.68). Edhe këtu shtrohet një pyetje interesante që ia vlen të diskutohet: Pse institucioneve të Kosovës u besojnë më së shumti ata që janë më së largu prej tyre (amviset), ndërkaq, ata që janë më afër tyre, dhe, nganjëherë, edhe brenda tyre (të punësuarit në sektorin publik) atyre u besojnë më së paku?

Një dukuri interesante dhe e rëndësishme është, po ashtu, te variabla e etnisë, ku grupet janë, shqiptarët, serbët, dhe të tjerët. Këtu, shqiptarët kanë besim shumë më të lartë në institucionet e përmendura se serbët, mirëpo, kategoria e të tjerëve këtyre institucioneve u beson edhe më shumë se shqiptarët. Sa i përket rajoneve të Kosovës, këtyre institucioneve, përgjithësisht, më së shumti u besohet në Ferizaj (dhe, pak më pak, në Pejë), ndërkaq, besimin më të ulët e kanë në Gjakovë.

Në tabelën e fundit janë dhënë përgjigjet e respondentëve sipas etnive dhe shpërndarjes së tyre nëpër rajonet e Kosovës, që japin më tepër hollësi për shpërndarjen e vlerësimeve sipas variablës së etnisë.

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?					
Alternativat	**N**	**Minimum**	**Maximum**	**Mesi**	**Dev. Standard**
Presidentes	1000	1	5	2.95	1.399
Kryeministrit	1000	1	5	2.67	1.385
Ministrit të Punëve të Brendshme	964	1	5	2.75	1.325
Policisë së Kosovës	1000	1	5	3.79	1.187
Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	921	1	5	3.17	1.209
Ministrit të Forcës së Sigurisë	953	1	5	3.33	1.281
Forcës së Sigurisë së Kosovës	1000	1	5	4.00	1.279
Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	947	1	5	3.02	1.350
Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	909	1	5	2.88	1.285
Komisionit Parlamentar për Inteligjencë	929	1	5	3.01	1.321

Tab 1. Besimi i përgjithshëm në institucione

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
D7 Përkatësia etnike		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
Shqiptar	**Mesi**	2.70	2.20	2.13	3.50	2.89	2.80	3.80	3.20	2.71	2.70
	N	10	10	8	10	9	10	10	10	7	10
Totali	**Mesi**	2.70	2.20	2.13	3.50	2.89	2.80	3.80	3.20	2.71	2.70
	N	10	10	8	10	9	10	10	10	7	10

Tab. 2. Shqiptarët e veriut

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
Serbët Veri-Jug		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
Serbët e Veriut	**Mesi**	1.04	1.00	1.00	1.54	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
	N	57	57	57	57	57	57	57	57	57	57
Serbët e Jugut	**Mesi**	1.07	1.02	1.09	1.99	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
	N	94	94	92	94	94	94	94	94	94	94
Totali	**Mesi**	1.06	1.01	1.05	1.82	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
	N	151	151	149	151	151	151	151	151	151	151

Tab.3. Serbët Veri-Jug

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
D11. Vendbanimi		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
Urban	**Mesi**	2.53	2.35	2.37	3.31	2.59	2.74	3.36	2.50	2.40	2.48
	N	544	544	529	544	508	519	544	511	500	502
Rural	**Mesi**	3.00	2.68	2.79	3.85	3.25	3.37	3.93	3.10	2.91	3.07
	N	456	456	436	456	413	435	456	436	414	428
Totali	**Mesi**	2.74	2.50	2.56	3.55	2.89	3.03	3.62	2.78	2.63	2.76
	N	1000	1000	965	1000	921	954	1000	947	914	930

Tab 4. Vendbanimi

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
D1. Gjinia		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
Mashkull	**Mesi**	2.73	2.46	2.52	3.55	2.89	3.04	3.71	2.76	2.66	2.81
	N	514	514	501	514	480	501	514	493	472	484
Femër	**Mesi**	2.76	2.54	2.60	3.56	2.89	3.02	3.53	2.79	2.60	2.70
	N	486	486	464	486	441	453	486	454	442	446
Totali	**Mesi**	2.74	2.50	2.56	3.55	2.89	3.03	3.62	2.78	2.63	2.76
	N	1000	1000	965	1000	921	954	1000	947	914	930

Tab.5. Gjinia

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
D2. Mosha		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
18-25	**Mesi**	2.68	2.50	2.49	3.49	2.96	3.04	3.59	2.86	2.68	2.88
	N	244	244	231	244	216	231	244	227	219	223
26-35	**Mesi**	2.72	2.45	2.55	3.57	2.87	3.01	3.59	2.74	2.63	2.69
	N	249	249	242	249	230	238	249	236	230	231
36-45	**Mesi**	2.74	2.55	2.56	3.58	2.92	3.06	3.71	2.77	2.58	2.71
	N	191	191	183	191	178	184	191	185	178	182
46-55	**Mesi**	2.71	2.44	2.51	3.54	2.79	2.93	3.56	2.72	2.57	2.68
	N	194	194	189	194	183	184	194	185	177	183
56-65	**Mesi**	3.01	2.64	2.71	3.63	2.92	3.19	3.71	2.72	2.68	2.75
	N	86	86	86	86	79	83	86	79	76	77
66+	**Mesi**	2.86	2.56	2.91	3.61	2.80	3.06	3.75	2.89	2.79	3.06
	N	36	36	34	36	35	34	36	35	34	34
Totali	**Mesi**	2.74	2.50	2.56	3.55	2.89	3.03	3.62	2.78	2.63	2.76
	N	1000	1000	965	1000	921	954	1000	947	914	930

Tabela 6. Mosha

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
D4. Edukimi		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
Shkolla fillore ose më pak	Mesi	3.05	2.75	2.81	3.64	2.89	3.14	3.56	2.94	2.81	2.85
	N	250	250	236	250	222	235	250	229	222	225
Shkolla e mesme	Mesi	2.76	2.45	2.59	3.62	2.99	3.08	3.74	2.84	2.62	2.81
	N	475	475	464	475	440	453	475	451	437	443
Disa vite te fakultetit	Mesi	2.41	2.48	2.36	3.57	2.78	2.98	3.52	2.60	2.63	2.62
	N	88	88	83	88	78	81	88	84	81	84
Shkolla e lartë	Mesi	2.05	1.74	2.17	2.81	2.00	2.24	2.71	2.02	1.88	2.23
	N	42	42	42	42	42	42	42	41	40	40
Fakulteti	Mesi	2.44	2.35	2.21	3.34	2.79	2.84	3.54	2.59	2.54	2.63
	N	116	116	112	116	111	115	116	114	107	111
Magjistraturë ose doktoraturë	Mesi	3.00	2.90	2.39	3.69	3.21	3.39	4.17	2.82	2.89	2.85
	N	29	29	28	29	28	28	29	28	27	27
Totali	Mesi	2.74	2.50	2.56	3.55	2.89	3.03	3.62	2.78	2.63	2.76
	N	1000	1000	965	1000	921	954	1000	947	914	930

Tab.8. Edukimi

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
D6. Profesioni i tashëm		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
I papunësuar - duke kërkuar punë	Mesi	2.33	2.18	2.30	3.23	2.59	2.59	3.21	2.47	2.33	2.43
	N	205	205	199	205	193	199	205	198	194	196
I papunësuar - duke mos kërkuar punë	Mesi	3.28	2.72	2.83	3.78	3.00	3.67	4.22	3.33	2.94	3.00
	N	18	18	18	18	16	18	18	18	16	18
I punësuar në sektorin publik	Mesi	2.02	2.03	1.92	2.92	2.18	2.21	2.68	2.15	2.09	2.02
	N	105	105	104	105	101	104	105	104	98	101
I punësuar në sektorin privat	Mesi	2.79	2.51	2.62	3.56	2.95	3.30	3.86	2.87	2.77	2.88
	N	243	243	235	243	230	235	243	232	224	228
I punësuar kohë pas kohe	Mesi	2.84	2.34	2.41	3.55	2.82	2.91	3.46	2.59	2.55	2.72
	N	82	82	81	82	76	79	82	74	74	75
Pensionist	Mesi	2.75	2.47	2.81	3.42	2.67	2.91	3.51	2.71	2.63	2.81
	N	55	55	54	55	54	53	55	52	52	52
Amvise	Mesi	3.45	3.16	3.20	4.23	3.61	3.66	4.25	3.50	3.14	3.34
	N	173	173	163	173	150	159	173	159	152	153
Student/ nxënës	Mesi	2.89	2.58	2.52	3.68	3.11	3.08	3.74	2.78	2.71	2.89
	N	106	106	98	106	88	95	106	97	91	94
Tjetër, specifiko:	Mesi	2.89	2.22	2.44	4.00	3.33	4.11	4.67	2.33	2.33	3.33
	N	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9
I/e vetëpunësuar	Mesi	1.50	2.00	2.00	3.50	2.50	2.33	4.25	2.00	2.25	2.25
	N	4	4	4	4	4	3	4	4	4	4
Totali	Mesi	2.74	2.50	2.56	3.55	2.89	3.03	3.62	2.78	2.63	2.76
	N	1000	1000	965	1000	921	954	1000	947	914	930

Tab. 9. Punësimi

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
D7 Përkatësia etnike		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
Shqiptar	Mesi	2.98	2.69	2.78	3.84	3.23	3.39	4.08	3.06	2.93	3.06
	N	749	749	723	749	694	716	749	712	683	699
Serb	Mesi	1.06	1.01	1.05	1.82	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
	N	151	151	149	151	151	151	151	151	151	151
Të tjerë	Mesi	3.51	3.28	3.28	4.06	3.51	3.62	4.15	3.51	3.19	3.40
	N	100	100	93	100	76	87	100	84	80	80
Totali	Mesi	2.74	2.50	2.56	3.55	2.89	3.03	3.62	2.78	2.63	2.76
	N	1000	1000	965	1000	921	954	1000	947	914	930

Tab. 10. Përkatësia etnike

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?											
Regjioni		Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
Prishtina	Mesi	2.52	2.49	2.48	3.62	2.85	3.11	3.94	2.70	2.53	2.46
	N	244	244	223	244	202	218	244	218	204	205
Mitrovica	Mesi	2.59	2.71	2.72	4.03	3.23	3.37	3.91	3.34	3.22	3.14
	N	113	113	107	113	107	107	113	106	102	105
Prizreni	Mesi	3.29	2.67	2.84	3.96	3.49	3.85	4.46	3.47	3.35	3.69
	N	162	162	161	162	159	162	162	159	158	161
Peja	Mesi	3.83	3.18	2.97	3.89	3.27	3.36	4.12	3.40	2.95	3.36
	N	94	94	90	94	67	81	94	78	65	75
Ferizaji	Mesi	4.00	3.72	3.84	4.25	3.87	3.87	4.37	3.71	3.69	3.72
	N	100	100	99	100	99	99	100	100	99	98
Gjakova	Mesi	2.05	1.75	2.10	2.78	2.15	2.20	2.20	2.00	1.97	1.93
	N	99	99	99	99	99	99	99	99	99	99
Gjilani	Mesi	2.15	1.90	1.97	3.20	2.37	2.26	3.02	1.87	1.71	2.07
	N	131	131	129	131	131	131	131	130	130	130
Veriu i Kosovës	Mesi	1.04	1.00	1.00	1.54	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
	N	57	57	57	57	57	57	57	57	57	57
Totali	Mesi	2.74	2.50	2.56	3.55	2.89	3.03	3.62	2.78	2.63	2.76
	N	1000	1000	965	1000	921	954	1000	947	914	930

Tab. 11. Rajoni

P1. Ju lutemi, na tregoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme në çështjet e sigurisë?												
D7 Përkatësia etnike			Presidentes	Kryeministrit	Ministrit të Punëve të Brendshme	Policisë së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës	Ministrit të Forcës së Sigurisë	Forcës së Sigurisë së Kosovës	Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Drejtorit të Agjensisë së Inteligjencës së Kosovës	Komisionit Parlamentar për Inteligjencë
Shqiptar	Prishtina	Mesi	2.53	2.53	2.62	3.67	3.06	3.30	4.19	2.83	2.71	2.63
		N	197	197	183	197	170	181	197	181	170	171
	Mitrovica	Mesi	2.56	2.63	2.67	4.04	3.27	3.43	3.99	3.38	3.25	3.16
		N	98	98	92	98	94	94	98	93	89	92
	Prizreni	Mesi	3.23	2.59	2.69	3.95	3.45	3.86	4.46	3.40	3.37	3.67
		N	128	128	127	128	128	128	128	126	126	128
	Peja	Mesi	4.01	3.29	3.07	4.09	3.50	3.58	4.39	3.67	3.17	3.56
		N	79	79	75	79	56	67	79	66	53	64
	Ferizaji	Mesi	4.47	4.11	4.24	4.61	4.31	4.31	4.96	4.11	4.08	4.14
		N	75	75	74	75	74	74	75	75	74	73
	Gjakova	Mesi	2.11	1.79	2.19	2.83	2.19	2.29	2.26	2.04	2.03	2.00
		N	89	89	89	89	89	89	89	89	89	89
	Gjilani	Mesi	2.76	2.41	2.43	3.94	3.16	2.99	4.19	2.38	2.12	2.70
		N	83	83	83	83	83	83	83	82	82	82
	Totali	Mesi	2.98	2.69	2.78	3.84	3.23	3.39	4.08	3.06	2.93	3.06
		N	749	749	723	749	694	716	749	712	683	699

Serb	Prishtina	Mesi	1.05	1.00	1.00	2.37	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
		N	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19
	Mitrovica	Mesi	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
		N	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5
	Peja	Mesi	1.14	1.14	1.00	1.43	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
		N	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7
	Ferizaji	Mesi	1.07	1.00	1.13	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
		N	15	15	15	15	15	15	15	15	15	15
	Gjilani	Mesi	1.08	1.02	1.13	1.92	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
		N	48	48	46	48	48	48	48	48	48	48
	Veriu i Kosovës	Mesi	1.04	1.00	1.00	1.54	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
		N	57	57	57	57	57	57	57	57	57	57
	Totali	Mesi	1.06	1.01	1.05	1.82	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
		N	151	151	149	151	151	151	151	151	151	151

Tab.11. Regjioni - Etniciteti

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Ky botim është përkrahur nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP), financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).